



REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIQUE DU KOSOVO  
GOVERNMENT - GOUVERNEMENT  
MINISTARSTVO EKONOMIKE  
MINISTRY OF ECONOMY

»HIDROREGJONI JUGOR« SIA.D.D.

Nr. 1748


Dt. 12.05 2025

PRIZREN

KRU Hidroregjoni Jugor sh.a. Prizren

Adresa: Wesly Clark p.n., 20000 Prizren  
email: sh.a-hidroregionijugor-prizren@hotmail.com


Bordi i Drejtoreve i K.R.U "Hidroregjoni Jugor" Sh.A, me seli në Prizren, në përputhje me nenin 30 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike si dhe në përputhje me nenin 17 Të Ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në mbledhjen e mbajtur me datë 12.05.2025, mori këtë:



VENDIM

Bordi i Drejtoreve miratoi Plan Biznesin e K.R.U "Hidroregjoni Jugor" Sh.A , për vitin 2025 – 2027, në mbledhjen e 2 (dytë) të mbajtur me 12.05.2025.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	<b>UD. Kryeshef Ekzekutiv Fadil Berisha</b>	<b>Kryesuesi i BD Ylber Elshani</b>
Nënshkrimi		
Data	12.05.2025	12.05.2025





**2025-2027**

## PLANI I BIZNESIT



K.R.U „HIDROREGJONI JUGOR“ SH.A

Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

Tel/ Fax : 029/ 244 150

E-Mail: [sh.a-hidroregionijugor-prizren@hotmail.com](mailto:sh.a-hidroregionijugor-prizren@hotmail.com)

[www.hidroregioni-jugor.com](http://www.hidroregioni-jugor.com)

	REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRATË E EKONOMISE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY		
Njësie Org: Org. Jedin: Org. Unit:	Nr. Prof: Br. Prof: Prof. No:	2137	2137
Nr. i fajave: Broj stranica: No. pages:	Dtih: Datum: Date:	13.05.25	13.05.25
PRISHTINË/A NO.1			

	PËRMBAJTJA	2
	HYRJE	6
1	PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME	7
1.1	Historiku i Kompanisë	7
1.2	Baza ligjore	8
1.3	Deklerata e politikës	9
1.4	Deklerata e „misionit”	9
1.5	Tarifat e shërbimit	10
2	DEPARTAMENTI I UJIT TË PIJES	11
2.1	Qëllimet dhe objektivat kryesore	12
2.2	Aktivitetet kryesore nga DUP	14
2.3	Rreziqet per mosarritjen e caqeve	14
2.4	Plani i investimeve kapitale	14
2.5	Rritja dhe perteritura e infrastruktures	17
2.6	Planifikimi i zvogëlimit të UPF-se	18
2.7	Plani i menaxhimit të aseteve	19
2.8	Prodhimi – 2025-2027	19
3	DEPARTAMENTI I UJËRAVE TË NDOTURA- ITUN	23
3.1	Fushëveprimtaria e Departamentit te –ITUN	23
3.2	Qëllimet dhe objektivat kryesore	23
3.3	Aktivitetet e planifikuara	24
3.4	Rreziqet qe mund te ndikojne ne mos arritjen e caqeve	24
3.5	Plani investiv	24
4	DEPARTAMENTI KOMERCIAL	31
4.1.1	Parashikimi i Kërkesës për ujë dhe rritja e konsumatorëve	32
4.1.2	Numri i Konsumatorëve- 2025-2027- KRU- HJ	32
4.1.3	Faturimi m3- 2025-2027- KRU- HJ	33
4.1.4	Faturimi € - 2025-2027	34

4.1.5	Arkëtimi € - 2025-2027	35
4.2	Masat e planifikuara per arritjen e objektivave financiare	37
4.3	Gatishmëria për të paguar	37
4.3.1	Trendet e kërkesave më të shpeshta të konsumatorëve	37
4.3.2	Kërkesat e performancës së shërbimit ndaj konsumatorëve	39
4.4	Plani Operacional	40
4.4.1	Planifikimi i zgjerimit të shërbimeve	40
4.4.2	Aktivitetet kryesore	40
5	DEPARTAMENTI I FINANCAVE	41
5.1	Analiza e shpenzimeve	41
5.2	Planifikimi i shpenzimeve	42
5.3	Arsyeshmeria e shpenzimeve	43
6	TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCE	44
7	SWOT - ANALIZA	44
8	PLANI I ZHVILLIMIT TË STAFIT	47
9	INVESTIMET – 2025-2027	50
10	ORGANOGRAMI	59


## **SHKURTESAT**

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ME	Ministria e Ekonomisë
MMPH	Ministriae Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë
KK	Kuvendi Komunal
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
DUP	Departamenti i ujit të pijes
NJOU	Njësia Operative e Ujësjellësit
NJPMNP	Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
BD	Bordet e Drejtoreve
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
KfW	Banka gjermane për zhvillim
UPF	Uji i pa-faturuar
OSH	Ofruesit e Shërbimeve
GIS (SIG )	Sistemi Informativ Gjeografik
SHUKOS	Shoqata e Ujësjellësve dhe Kanalizimit të Kosovës
ITUN	Implant i Trajimit të Ujërave të Ndotura
UNMIK	Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë

## MBËLUESHMËRIA ME SHËRBIME

KRU "HIDROREGJIONI JUGOR" Sh.A Prizren

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit, viti 2022



Punoi: Shërbimi TEKNIK

## **HYRJE**

**Plani i Biznesit për vitin 2025-2027** është një planifikim i caqeve kryesore të Kompanisë bazuar në një Modul i përgatitur paraprakisht. Planifikimi i caqeve bazohet në synimet e të gjitha Njësive Punuese, në baza mujore dhe vjetore.

(Ekziston një modul i plotë në baza mujore)

Gjatë përgatitjes së këtij Plani të Biznesit janë angazhuar të gjitha shërbimet përkatëse të Kompanisë.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar planifikimeve mujore të të gjitha performacave e veçanërisht atyre operative dhe financiare.

Forma e përgatitjes së këtij Plani të Biznesit është bazuar edhe në kërkesat për raportim nga ARRU si dhe institucionet tjera.

Qëllimi kryesorë i këtij modulli është mundësia e kontrollit të prformancave dhe arritjes se caqeve, në çdo muaj, duke filluar nga shërbimet e caktuara, Njësitë Punuese e deri tek niveli regional.

Ky plan definon qartë orientimet zhvillimore të Kompanisë dhe objektivat si dhe rezultatet e pritshme duke marrë përbazë edhe rezultatet e arritura në periudhën paraprake.

Plani është përgatitur duke pas parasysh gjendjen ekzistuese të Kompanisë, trendet e zhvillimit të sektorit të ujit në Kosovë si dhe jashtë Kosovës për të adoptuar praktikat më të mira të njoitura për një zhvillim të qëndrueshëm të Kompanisë.

**Plani i Biznesit 2025-2027** definon qartë rrugën e zhvillimit të Kompanisë duke marrë parasysh përparësitet dhe rreziqet për realizimin e suksesshëm që do të rezultojë me një arritje të vetë qëndrueshmërisë financiare të Kompanisë. Parametrat financiar dhe operativ janë analizuar në mënyrë që të janë të arritshme (duke lënë mundësinë e tejkalimit të të njëjtave) dhe të janë sa më afër realitetit.

Plani i Biznesit është i orientuar fuqishëm edhe në drejtim te Institucioneve financiare dhe Donatorëve ku realizimi i këtij plani, e sidomos i Planit të investimeve kapitale është i varur edhe nga përkrahja që do të sigurohet nga Donatorët, Institucionet financiare si dhe institucionet qendrore dhe lokale.

## **1. PËRMBLEDHJA E PËRGJITHSHME**

### **1.1 Historiku i Kompanisë**

Në vitin 1962 ka filluar të ushtrojë veprimtarinë e saj si ndërmarrje Shoqërore e njohur me emrin "Cvileni, që nga viti 1999 ka funksionuar si Ndërmarrje Publike nën DSHP shtylla e IV e UNMIK-ut, ndërsa që nga mesi i vitit 2003 kjo Kompani është regionalizuar me 4 njësi në vete: Prizren, Suharekë, Dragash dhe Malishevë.

Që nga Koriku i vitit 2007 funksionon si Shoqëri Aksionare K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" SH.A. Kompania e ujësjellësit rajonal Hidroregjioni Jugor, shërbimet e veta i ofron në pjesën jugore të Kosovës duke përfshirë këto komuna:

- **Komuna e Prizrenit - Qyteti i Prizrenit dhe 39 Fshatra**  
( Numri total i fshatrave- 72)
- **Komuna e Suharekës – Qyteti i Suharekës dhe 33 Fshatra**  
(Numri total i fshatrave – 42)
- **Komuna e Dragashit – Qytezi i Dragashit dhe 3 Fshatra**  
(Numri total i fshatrave - 38)
- **Komuna e Malishevës – Qyteti i Malishevës dhe 36 Fshatra**  
(Numri total i fshatrave - 44)
- **Komuna e Mamushës**

Rrjeti furnizues që i kryen shërbimet përfshinë 4 njësi operacionale dhe 5 Komuna: Prizren, Suharekë, Dragash , Malishevë dhe Mamushë.

Furnizimi me ujë bëhet prej burimeve vetanake. Në nivel te Kompanisë furnizohen edhe 64 fshatra që janë të kyçur ne rrjetin e Kompanisë Rajonale Prizren, Suharekë, Malishevë.

Numri i popullatës në të cilën Kompania e Ujësjellësit Regional Prizren i kryen shërbimet e veta vlerësohet të jetë rreth 200.000 banorë.

Kapaciteti prodhues perfshire kapacitetet pemes puseve i cili eshte alternativ si dhe burimet te cilat nuk janë te shfrytezuara aktualisht me kapacetet te plotë. Furnizimi bëhet 45% përmes pompimit dhe 55% me gravitet.

## 1.2 Baza ligjore

KRU "Hidroregjioni Jugpr" Sh.A. me seli ne Prizren, është e organizuar në cilësinë e shoqërisë tregtare. Aksionet janë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Veprimtarinë e saj operative dhe financiare do t' a organizojë dhe përmbushë, duke pasur për bazë detyrimet në zbatimin e akteve dhe dispozitave ligjore të miratuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës:

- Ligji nr. 04/L - 006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare;
- Ligji mbi Ndërmarrjet Publike (nr. 03/L-087);
- Ligjit nr. 04/L-111 për Plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet publike;
- Ligji nr.05/L -009 për Plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet publike nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet publike i ndryshuar dhe plotësuar nr. 04/L-111;
- Ligji mbi afruesit e shërbimeve të ujut dhe mbeturinave (nr. 03/-L-086);
- Ligji mbi menaxhimin e financave publike (2008/03 L048);
- Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive (2012/04-L-116);
- Ligji mbi ujërat (04/L-147);
- Ligji i punës (2010/03-L-212);
- Ligji mbi mbrojtjen e të dhënave personale (2010/03-L-172); dhe
- Ligji mbi festat zyrtare (03/L-064).

### **1.3 Deklarata e politikës**

Menaxhmenti i KUR "Hidroregjioni Jugor" SH.A. i përkrahur nga palët e interesit (Bordi i Drejtoreve, aksionarët, konsumatorët, etj) dhe me ndihmën e të gjithë punëmarrësve kanë për qëllim furnizimin me ujë pa ndërprerë të të gjithë konsumatorëve në zonën e shërbimit.

Për të arritur këtë objektiv, do të vihen në dispozicion të gjitha burimet njerëzore dhe burimet financiare që të minimizohen humbjet teknike dhe humbjet administrative të ujit nga njëra anë dhe të maksimalizohen të gjitha aktivitetet lidhur me rritjen e shkallës së arkëtimit.

Prandaj është një prioritet i përcaktuar zvogëlimi i sasisë së ujit pa të ardhura dhe pagesa për shërbimet.

Përmes këtyre aktiviteteve në të ardhmen do të krijohen kushte të favorshme për rritjen e nivelit të investimeve nga burimet vetanake.

Përbushja e një vizioni te tillë do të krijonte parakushte më të mira për investime nga donatorët dhe agjensionet tjera financiare.

### **1.4 Deklarata e "misionit"**

Misioni i KUR " Hidroregjioni Jugor" Sh.A. është: furnizimi me ujë të pijshëm, largimi i ujërave të ndotura, mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm si dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujërave të ndotura.

Orientimi i aktiviteteve të punës do ta ketë konsumatorin në qendër të vëmendjes. Të gjithë konsumatorët do të kenë trajtim dhe qasje në shërbim: pa diskriminim racor, pa diskriminim në përkatësinë religjioze, pa diskriminim në përkatësinë kombëtare, pa diskriminim në përkatësinë gjinore.

Duke përbushur këtë "mision" do të bëhet i mundur sigurimi i një aktiviteti të vetë financueshëm me qëllimin e fundit që të sigurojmë shërbime cilësore të ujit të pijshëm në pajtim me standartet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Çasja e afarizmit të kompanisë do të jetë transparente dhe e bazuar në dispozitat ligjore. Kjo do të bëhet në bashkëpunim me palët e interesit:

- Punëmarrësit,
- Aksionarët-Bordin e Drejtoreve - Qeveria
- Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,
- Ministrinë e Ekonomisë dhe Ministria e Financave,
- ARRU (Autoriteti Rregullativ i Ujërave)
- Konsumatorët (të organizuar në komisione, shoqata etj).

## 1.5 Tarifat e shërbimit

Kompania KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. do të zbatojë tarifën e çmimeve që do ta vendlloj Zyra Rregullative për Ujë dhe Mbeturina sipas Ligjit N 03/L-086 si autoritet i vetëm dhe kompetent për përcaktimin e tarifave. Në bazë të kësaj Rregulloreje është përcaktuar "mbulimi i të gjitha kostove të operimit dhe investimeve"

Tarifat e miratuara nga ARRU do të janë ekskluzivisht në funksion të mbulimit te shpenzimeve operative, rritjes së investimeve kapitale dhe përpjekjes për bashkëfinancimin e shumë projekteve të mundshme kapitale me komunitetin, me komunat përkatëse dhe me donatorët. Rritjet e reja do të ndikojnë pozitivisht dhe do të mobilizojnë menagjmentin dhe personelin tjetër në KUR "Hidroregjioni Jugor" SH.A. në përmbrushjen me sukses të misionit të përcaktuar.

### TARIFAT E PRITSHME PËR SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAT E NDOTURA 2024

Tabela:1

Kategoria e konsumatorit	Tarifa fiksë (Euro/muaj)	Tarifa volumetrike për ujë të pijes (Euro/m <sup>3</sup> )	Tarifa volumetrike të ujërave të ndotura (Euro/m <sup>3</sup> )
Konsumatori Shtëpiak	1.0	0.38	0.14
Konsumatori Komercial/Industrial	2.0	0.57	0.32
Konsumatori institucional	2.0	0.57	0.32

## TARIFAT E PRITSHME PËR SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAT E NDOTURA 2025

Tabela:2

Kategoria e konsumatorit	Tarifa fikse (Euro/muaj)	Tarifa volumetrike për ujë të pijes (Euro/m <sup>3</sup> )	Tarifa volumetrike të ujërave të zeza (Euro/m <sup>3</sup> )
Konsumatori Shtëpiak	1.0	0.40	0.15
Konsumatori Komercial/Industrial	2.0	0.55	0.32
Konsumatori institucional	2.0	0.55	0.32

## 2. DEPARTAMENTI I UJIT TË PIJES

DUP përgjejgjësinë dhe fushëveprimtarinë e ushtron kryesisht në tre divizione kryesore:

1. Planifikimi dhe zhvillimi teknik
2. Prodhimi dhe furnizimi me ujë të pijes
3. Zvogëlimi i UPF – humbjeve të ujit

### 2.1 Qëllimet

- Zgjerim të zonës shërbyeze (96 %) me synim të rritjes së përqindjes së popullatës në qasje të shërbimeve me ujë të pijes dhe kanalizime duke përmbrushur kriteret e ndikimit ambiental dhe ngritisës së mirëqenies socio ekonomike për popullatën brenda zonës së shërbimit,
- Sigurimin e shfrytëzimit racional të burimeve të ujit;
- Sigurimin e furnizimit me ujë të konsumatorëve ekzistues dhe atyre të ri në 24 orë dhe rregullimin e presionit sipas standardeve aplikative për të gjitha zonat sikurse dhe zonat problematike të furnizimit.

- Sigurimin e furnizimit me ujë të cilësisë dhe kualitetit në pajtim me standardet e IKSHPK-se, gjegjësish 100% pajtueshmërinë e testeve të ujit;
- Zgjerimi i zonës së shërbimit në trajtimin e ujerave të ndotura përmes planifikimit dhe inicimit të projekteve për ndërtimin e ITUN-ve parçiale dhe qendrore..
- Promovimin e relacioneve të mira me konsumatorë
- Afarizmin rentabil me vetë qëndrueshmëri financiare, përmes rritjes së normës së mbulesës së punës;
- Rritja e vlerës së aseteve për periudhën 2025-2027
- Zbatueshmerinë e plotë të Regulloreve të ARRU përfshirë Standardet Minimale të Shërbimeve, Licencimit, Kartën e Konsumatorëve, Politikën Tarifore të ARRU, dhe të tjera, për sigurimin cilësor të shërbimeve si dhe arritjen e të ardhurave të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve operative dhe investimet e domosdoshme vjetore që përcaktohen nga Planifikimi i ardhshëm i Menaxhimit të Aseteve;
- Pëmirësimi i dukshëm dhe avancimi i furnizimit me ujë
- Kontrolli permanent i cilësisë se ujit dhe presionit komfor standardeve në fuqi
- Zvogëlimi optimal i humbjet teknike e komerciale
- Zvogëlimi i shpenzimeve operative të mirëmbajtjes e operimit
- Shtimi dhe avancimi i shërbimeve të Kompanisë
- Preventimi i mundësisë së ndotjes së ujit të pijes nga ujerat e zeza

## 2.2 Objektivat

- Funksionimi i plote dhe efikas i rrjetit te ujësjellësit dhe kanalizimit
- Mirëmbajta dhe operimi i rregullt i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit;
- Sanimi dhe aftësimi kualitativ dhe në kohe i të gjitha prishjeve në ujësjellës dhe kanalizim
- Zhvillim i strategjive përmes aktiviteteve të ndryshme për zvogëlimin e humbjeve të ujit të pijes, në theks të veçantë vendosja e ujëmatësve të konsumatorëve në pronë publike për të pamundësuar keqpërdorimin e ujit,
- Implementimi i të gjitha projekteve të planifikuara për vitet 2025-2027, me theks të veçantë për vitin 2025,

- Zonimi i sistemit të ujësjellësit për të siguar furnizim komfor standardeve të kërkuara,
- Formimi i DMA zonave dhe aplikimin e modelimeve hidraulike që mundësojnë analizat dhe studimet e mirëfillta teknike me objektiv në zvogëlimin e humbjeve teknike dhe administrative,
- Krijimin e ambientit të favorshëm dhe sigurisë në punë për të gjithë të punësuarit;
- Sigurimin e stabilimenteve e pajisjeve të teknologjive moderne, të cilat përdoren për kryerjen e aktiviteteve të Kompanisë, dhe që përbushin kërkesat për mbrojtje të shëndetit, sigurisë dhe të mjedisit.
- Regjistrimin dhe ruajtjen elektronike e fizike të të gjitha të dhënavë dhe informacioneve të Kompanisë dhe organizimin e tyre në Sistem Informativ Menaxhues e funksional;
- Monitorimin e saktë të prodhimit dhe furnizimit të ujit si dhe grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura përmes pajisjeve matëse të instaluara në pikat e prodhimit dhe shpërndarjes së ujit duke përfshirë edhe sistemet elektronike monitoruese SCADA;
- Vazhdimin e avancimit të sistemit të të dhënavë gjeografike (GIS) për të përfshirë tërë zonën e shërbimit dhe hartimin e Planit të Menaxhimit të Aseteve;
- Operimi funksional i MMS - Sistemi i menaxhimit te mirëmbajtjes e operimit, i cili mundëson menaxhiminin e urdhëresave dhe përbylljen e tyre duke gjeneruar raportet përkatëse.
- Operimi funksional i MMA - Aplikacioni mobil për menaxhimin e mirëmbajtjes e operimit.
- Rritja e transparencës në raportimet të cilat i përgatitë Kompania ndaj menaxhmentit, Bordit dhe palëve të treta te interesuara;
- Finalizimi i dy dokumenteve ne proces te cilat kanë te bëjnë me: -Menaxhimin e Krizave dhe Menaxhimin e rrezikut.

➤ Aktivitetet e planifikuara janë në funksion të realizimit te projekteve te parapara në këtë Plan Biznes të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt ne realizimin e caqeve:

- Realizimi i projekteve investive komfor Planit te Biznesit
- Participimi financiar dhe mbështetja e plote profesionale për realizimin e projekteve të kësaj fushë veprimtarie të planifikuara nga institucionet lokale, qendrore dhe tjera.
- Operimi optimal i të gjitha shërbimeve teknike në funksion të sigurimit dhe furnizimit të qëndrueshëm, kualitativ dhe cilësor me ujë të pijes.
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm

- Intervenimi efikas, profesional dhe eficientë në sanimin e prishjeve apo pengesave ne funksionim te infrastrukturës ujore me qellim të zvogëlimit të humbjeve
- Aktivitetet ne instalimin e ujëmatësve te prodhimit dhe ujëmatësve zonal ne te gjitha pikat prodhuese e distributive të rrjetit te cilat do të mundësojnë monitorimin e sakte te prodhimit dhe furnizimit te ujit,
- Instalimi i ujëmatësve te të gjithe konsumatorët dhe përpjekjet e pandërprera që çdo konsumatori t' i matet sasia e ujit të shpenzuar dhe t' i bëhet faturimi në bazë të shpenzimit real,
- Dislokimi i ujëmatësve ekzistues nga prona private ne prone publike sa me afér gypit furnizues, me qellim te preventimit të keqpërdorimeve apo ndërhyrjeve te palejuara ne rrjetin e ujit te pijes,
- Studimi i fisibilitetit për Implementimin e sistemit SCADA për monitorimin dhe menaxhimin e avancuar teknik operacional të prodhimit e furnizimit te ujit te pijes.
- Avancimin profesional e ekspeditiv te ekipeve te mirëmbajtjes se stabilimenteve Elektroteknike – Mekanike e Hidraulike,
- Pasurimi dhe azhurnimi i Sistemit Gjeografik të Informimit me të dhëna të reja - GIS,
- Trajnimi dhe avancimi profesional i kuadrove në fusha të ndryshme si: në teknologjite bashkëkohorë të trajtimit të ujerave të pijshëm dhe ujërave të zeza
- Zbatimi i rregulloreve te hartuara nga zyra e rregullatorit ne lidhje me menaxhimin dhe funksionimin e sistemeve të ujerave të ndotura
- Zbatimi i udhëzimeve administrative për shkarkimet e ujerave të ndotura në sistem dhe trajtimin e tyre si parakusht i domosdoshëm për derdhje në recipient me lëshimin në operim te ITUN,
- Avancimi dhe ngritja profesionale e stafit punues përmes trajnimeve përkatëse profesionale, studimeve të avancuara, pjesëmarrjes ne konferanca dhe aktivitete që trajtojnë këtë fushë veprimtari për të qenë koherent me zhvillimet teknologjike e humane..
- Zbatimin dhe jetësimin e dokumenteve përkatësisht planeve ne dispozicion te miratuara dhe ne hartim e sipër mbi rreziqet e mundshme:
  1. Planin e menaxhimit te thatësirave,
  2. Planin e furnizimit me ujë te pijes ne situata emergjente,
  3. Planin e investimeve afatgjata,
  4. Plani i menaxhimit te rrezikut
  5. Plani i menaxhimit të krizave.

6. Plani për menaxhimin e aseteve
7. Strategjia për zvogëlimin e humbjeve të ujit
8. Plani i veprimit për zvogëlimin e humbjeve teknike të ujit të pijes

### **2.3 Reziqet që mund të ndikojnë në mosarritjen e caqeve**

- Mosrealizimi i investimeve te parapara në Blan Biznes,
- Prolongimi i projekteve bashke financuese për shkak te dështimit te investimeve nga institucionet qendrore e lokale dhe agjencionet tjera financiare.
- Vazhdimi i efektit te pandemisë apo fatkeqësive tjera natyrore.
- Eficienca operative ne aspektin e sanitit te prishjeve e cila mund të rezultojë në sigurinë e cilësisë se ujit, shtypjes dhe furnizimit te rregullt me ujë te pijes, dhe ne plotësimin e standardeve minimale te shërbimit dhe mirëmbajtje te kanalizimit.
- Pengesat objektive operacionale te programeve aplikative për GIS dhe aplikacioneve MMS dhe MMA, te cilat drejtpërsëdrejti ndikojnë në mirëmbajtjen e aseteve të kompanisë,
- Legjislatura e pamjaftueshme që mbulon këtë fushë veprimtari dhe mos zhuritet i organeve të drejtësisë për ndjekjen e keqpërdoruesve dhe shkelësve te ligjit.

### **2.4 Plani i investimeve kapitale**

Plani i Investimeve është pjese e rëndësishme e Planit te Biznesit, i cili i mundëson ujësjellësit të përmirësojë dhe avancojë shërbimet ndaj konsumatorëve dhe sensibilizimin e përgjegjësisë qytetare për pagesat e faturave ujore.

Plani i investimeve përbëhet prej disa kategori projektesh dhe burimesh financiare me theks të veçantë ne përmirësimin dhe avancimin e gjithmbarshëm të infrastrukturës ujore, zgjerimin e zonave shërbyses, zvogëlimin e humbjeve dhe avancimin e programeve aplikative monitoruese, menaxhuese e operative.

Varësisht prej mundësive buxhetore dhe vlerave të përcaktuara nga ARRU, janë përcaktuar projektet me financim vetenak, projektet me participim me agjencionet tjera financiare sikurse dhe projektet madhore, qe kalojnë dimensionet dhe mundësitë financiare të Kompanisë dhe që janë referuar strategjive zhvillimore lokale, nacionale e me gjere dhe burimeve tjera financiare që mbulojnë këtë fushë veprimtari.

Qëllimi i Planit të Investimeve konsiston në përcaktimin e konturave zhvillimore komfor orientimeve strategjike dhe planifikimeve të bazuara për përbushjen e misionit dhe vizionit të Kompanisë.

Përcaktimi dhe përzgjedhja e projekteve investive është rezultuar kryesisht ne baze te:

- Infrastrukturës së gjithmbarshme të të dhënave ne dispozicion.
- dokumenteve analitike e financiare,
- elaborateve fisibile e studimore,
- raporteve e auditeve periodike e vjetore
- vlerësimeve te licencuara te gjendjes se aseteve ne dispozicion
- Programeve aplikative operacionale, të shërbimeve të mirëmbajtjes e operimit dhe shërbimeve tjera te Kompanisë.

Pjese integrale e aktiviteteve është harmonizimi me strategjitë zhvillimore komunale e qendrore dhe projektet mbështetëse nga donacionet apo institucionet tjera financiare.

Potencialet financiare planifikohen të janë projektet investive te planifikuara nga:

- o Linjat e planifikuara buxhetore te investimeve kapitale nga komuna e Prizrenit, Suharekës, Malishevës dhe Dragashit.
- o Projektet kapitale të strategjisë nacionale (ME, MF, MIPH, etj.) dhe modalitetet bashkë financuese si programet PIP apo ngjashëm
- o Mjetet vetanake (nga Kompania)
- o Grandet nga Institucionet zhvillimore financiare apo agjpcionet tjera qe mbulojnë dhe përkrahin këtë fushë veprimtari sikurse janë:



## 2.5 Përtëritja dhe rritja e infrastrukturës

Rajoni i Prizrenit dhe hapësira menaxhuese e kompanisë identifikohet me dominim të rrjetit të vjetër, te ndërtuar ne periudha te ndryshme kohore, viteve 60-ta (parcialsht edhe me herët), materiale të konsumuar nga koha dhe standarde teknike të tejkaluara.

Nevojat investive në këtë drejtim janë shumë të mëdha, të domosdoshme por që kanë kosto të konsiderueshme. Ky aktivitet mund të realizohet pjesërisht nga Kompania por mjaftueshëm vetëm me involvimin dhe mbështetjen e institucioneve lokale, qendrore, Institucioneve financiare zhvillimore te jashtme dhe donacioneve potenciale.

Realizimi planifikohet ne fazë sipas mundësive financiare dhe prioriteteve

Përcaktimin e prioriteteve dhe nevojave emergjente investive në ripërtëritjen e infrastrukturës se ujësjellësit e determinojnë raportet, analizat teknike e studimet përkatëse të segmenteve ku janë konstatuar prishje te shpeshta, humbje teknike, lidhje ilegale, presion jashtë standardeve, rrjete i amortizuar, përmbajtje me efekte negative shëndetësore etj..

Me zgjerimin e zonës shërbysese, komfor marrëveshjeve paraprake sipas praktikës se deritashme, parashihen dhe investime në trasa të reja furnizuese, burime te reja te ujit, aftësime dhe rehabilitime te rrjetave ekzistuese jofunksionale e te ngjashme.

Pjese integrale e këtyre investimeve janë përmirësimi dhe vendosja e infrastrukturës se re te kanalizimit te vendeve rurale por edhe ne disa lagje periferike, me derdhje te ujerave te ndotura jashtë kriterieve te lejuara te cilat kane efekt negativ sidomos ne ndotje te ujërave sipërfaqësore, burim te epidemive e rreziqe tjera. Këto planifikime investive synojnë përmbushjen e kriterieve për trajtimin e ujerave te ndotura te përcaktuara nga Bashkimi Evropian.

*P.S: Plani i detajuar i investimeve 2025-2027 është i paraqitur në shtesën e veçantë*

## 2.6 Planifikimi i zvogëlimit të humbjeve të ujit

Sfidë serioze e kompanisë është zvogëlimi i humbjeve të ujit përkatësisht humbjet teknike. Investimet në këto projekte kërkojnë impenjim të plotë të gjitha departamenteve dhe kosto te konsiderueshme financiare. Bazuar në matjet e realizuara gjatë periudhave TM2 - TM3 dhe raportimeve të prodhimit dhe përqindjes së humbjeve të ujit të pijes, krahasuar me parametrat e përcaktuara nga ARRU, sipas planifikimeve investive të PB, synohet që deri në vitin 2027, në baza vjetore, të zvogëlohen humbjet e ujit në 7.9% Nga 72.16 % sa janë aktualisht në 64.30 %. Enkas për realizimin e këtij objektivi njëkohësisht është hartuar dhe Strategjia për zvogëlimin e humbjeve të ujit të pijes 2023-2025 që ka gjeneruar dhe Planin e veprimit me aktivitetet konkrete për realizimin e tij. Rekomandohet që të bëhet azhurnimi i këtij plani në përputhshmëri me objektivat e procesit të aplikimit tarifor 2026-2028.

Gjithashtu sipas rekomandimeve te ARRU-se, investimet ne zvogëlimin e humbjeve duhet te arrijnë ne 1/3 e planifikimeve te gjithmbarshme vjetore te investimeve kapitale te kompanisë. Komfor këtyre caqeve janë përzgjedhur dhe projektet investive të cilat konsistonë në:

- Zëvendësimin e rrjetit të amortizuar dhe vjetruar
- Avancimin e teknologjisë depërtuese dhe detektimi permanent i rrjedhjeve të ujit
- Evidencimin me kohe dhe intervenimi optimal eficient në sanimim e rrjedhjeve nëntokësore dhe mbitokësore
- Proritizimin e intervenimeve ne segmentet sipas evidencës se programeve aplikative operuese MMS dhe MMA te prishjeve te shpeshta dhe me vështirësi funksionimi.
- Instalimin, zëvendësimi i ujëmatësve te prodhimit dhe ujëmatësve zonal ne te gjitha pikat prodhuese e distributive te rrjetit te cilat do te mundësojnë monitorimin e sakte te prodhimit dhe furnizimit te ujit,
- Instalimi i ujëmatësve te te gjithe konsumatorët dhe përpjekjet e pandërrrera që çdo konsumatori t' i matet sasia e ujit të shpenzuar dhe t' i bëhet faturimi në bazë të shpenzimit real,
- Dislokimi i ujëmatësve ekzistues nga prona private ne prona publike sa me afér gypit furnizues, me qellim te preventimit te keqpërdorimeve apo ndërhyrjeve te palejuara ne rrjetin e ujit te pijes,
- Intensifikimin e aktiviteteve për përafrimin përmbyllës te incizimit gjeodezik, digjitalizimit te rrjetit te ujësjellësit, përditësimit te te dhënave ne sistemin Auto Cad dhe sistemimi i tyre ne GIS,
- Zonimet DMA dhe modelimet hidraulike.
- Planifikimi i resurseve njerëzore –trajnimet dhe avancimet profesionale

## 2.7 Plani i menaxhimit të aseteve

Gjendja aktuale e aseteve të kompanisë është vlerësuar nga OE i licencuar gjate vitit 2020, sipas kritereve dhe standardeve aplikative për këtë veprimtarji.

Duke pasur parasysh gjendjen e tanishme të aseteve, mendojmë se përgjatë kohës nuk ka qenë planifikim i mirëfilltë në menaxhimin e aseteve dhe gjendja e tyre është jo e kënaqshme. Asetet që tani i kemi në shfrytëzim janë sipas periudhave të ndërtimit para lufte dhe pas lufte.

Duke parë gjendjen e aseteve pas lufte janë bërë investime në Rehabilitimin dhe ndërtimin e rezervuarëve të rinjë, rrjetet të ujësjellësit, fazoneri, ujëmatës të profileve të ndryshme si dhe në mjetet e punës, ndihma me makineri në shtimin e sasisë së ujit, në kualitetin e ujit.

Të gjitha këto ndihma, investime kanë ndikuar në përmirësimin e gjendjes së aseteve dhe performansës se Kompanive.

Duke e parë këtë mungesë të vazhdueshme, me instrukzionet dhe mbështetjen e ARRU-së, Kompania ka hartuar Planin bazë për menaxhimin e aseteve të aprovuar nga ARRU, që kryesisht përfshinë vitin 2024 për t'u vazhduar pandërprerë në azhurnimin dhe përditësimin e planit gjithnjë në varësi prej progresit investiv e zgjerues të Kompanisë.

Duke pasur parasysh gjendjen e aseteve dhe analizave të bëra nga të dhënrat e përditshme kemi përcaktuar objektivat dhe prioritetet e projekteve.

Objektivat tona për të pasur një menaxhim më të mirë dhe kontrollë mbi asete janë:

- Incizimin Gjeodezik, Digjitalizimi i rrjetit te kanalizimit dhe rrjetit te ujësjellësit, Modelimi Hidraulik, përditësimi i te dhënavë ne sistemin Auto Cad dhe sistemi i tyre ne GIS, kritere këto te kërkura në vazhdimësi ARRU, Qeveria e Kosovës dhe nga donatoret potencial.
- Kompletimi i regjistrat të aseteve duke shfrytëzuar aplikacionet e avansuara softverike dhe pajisjet hardverike për këtë veprimtarji dhe duke u shërbyer me regjistrimet vjetore të kompanisë dhe raportit final të rivlerësimit të aseteve të përfunduara nga OE i licencuar i kontraktuar në vitin 2020.
- Incizimi, evalumi dhe regjistimi i aseteve të reja me tërë infrastrukturën përcjellëse pas përfundimit të investimeve nga donator të ndryshëm dhe gjatë procesit të marrjes në menaxhimt të zonave të reja shërbysese.
- Procedimi final i asgjësimit të aseteve me amortizim të skaduar dhe ç ‘regjistrimet nga librat kontabël.


- Sistemimi adekuat i çdo materiali apo pjesëve përcjellëse sipas specifikave teknike e destinimit dhe paisja me fletëregjistrim të veçantë – bar kod me emërtim të saktë për identifikim dhe evidentim të të gjitha aseteve.
- Vendosja, palimi, sistemi dhe mbrojtja adekuate nga ndikimet mekanike, fizike e atmosferike të paisjeve apo materialeve që janë jashtë objekteve të depove.
- Plotësimi i rregullatives së brendshme –adresimi më i mirë dhe më i saktë i përgjegjësive dhe zbatueshmeri e procedurave të punës në përpikëri nga përgjegjësit e thirrur,
- Planifikimi i dokumentacioneve planifikuese investive dhe avansimeve e plotësimeve të resurseve njerëzore. Realizimi i projekteve investive dhe aktivitetave operuese sipas dinamikës së planifikuar

## 2.8 PRODHIMI- m3 – 2025-2027

Tabela Nr.3

2025-2027						
K.R.U „HIDROREGJONI JUGOR“ SH.A - PRIZREN						
No.	Të dhënat	2023	2024	2025	2026	2027
		m3	m3	m3	m3	m3
	NJËSIA P.					
1	PRIZREN	23,219,584	23,884,372	23,968,576	23,959,204	23,996,981
2	SUHAREKË	4,542,743	4,339,501	4,247,491	4,386,014	4,415,600
3	MALISHEVË	2,615,488	2,344,387	2,206,362	2,355,652	2,361,275
4	DRAGASH	957,996	917,346	904,130	1,012,442	1,013,289
6	TOTAL	31,335,811	31,485,607	31,326,560	31,713,312	31,787,145
NDRYSHIMI			149,796	(159,047)	386,752	73,833
NDRYSHIMI %			0.5%	-0.5%	1.2%	0.2%

### PRODHIMI m3- 2025-2027



➤ Pasqyrimi i projekzionit të prodhimit për periudhën 2024 – 2027 kryesisht është bazuar:

- Matja optimalisht reale e prodhimit në periudhën TM2 – TM3, 2024
- Projekzioni i prodhimit në TM4 sipas mesatares së prodhimit TM2 dhe TM3.
- Implementimi i Strategjive dhe Planeve të veprimit në zvogëlimin e humbjeve të ujit, menaxhimin e aseteve dhe avansimin e teknologjisë sofverike e hardverike.

### *Aktivitetet për zvogëlimin e UPF-së*

Projekioni i përcaktuar i përqindjes së zvogëlimit të humbjeve teknike të ujit për periudhën 2025 – 2027 është mbështetuar kryesisht në këta faktorë:

- Strategjia 2023-2025 për zvogëlimin e humbjeve të ujit
- Plani i veprimit 2024 për ndërmarrjen e aktiviteteve të drejtpërdrejta nga Departamenti Komercial dhe Departamenti i Ujit të Pijes përfshirë dhe të gjitha Departamentet tjera të nevojshme të Kompanisë
- Realizimi i projekteve të përcaktuara sipas PB për investimet kapitale vetanake dhe me donator
- Promovimi

Realizimi i përqindjes së synuar te humbjeve për periudhën 2025 – 2027 paraqet sfidë serioze dhe vështirë të realizueshme sidomos ne aspektin teknik duke pasë parasysh këta faktor;

- Rrjeti i ujësjellësit dhe infrastruktura e gjithmbarshme e sistemit me përqindje te theksuar e amortizuar dhe në gjendje te pavolitshme teknike
- Kosto shume e lartë financiare për investime ne zvogëlimin e humbjeve teknike
- Mundësitet e limituara buxhetore të kompanisë

Faza e I-rë:

- Riparimi efektiv i rrjedhjeve të dukshme,
- Detektimi sistematik i rrjedhjeve të padukshme dhe riparimi i tyre,
- Rehabilitimi/zëvendësimi i rrjetit të vjetruar me asistencën e donatorëve
- Definimi dhe krijimi i zonave të matura (DMA)
- Menaxhimi i presioneve

Faza e II-të:

- Monitorimi i humbjeve në zonat e matura
- Përcaktimi i saktë i bilancit ujor
- Menaxhimi i presioneve
- Rehabilitimi sistematik i rrjetit dhe kyçjeve shtëpiake

Vështirësitetë në përbushjen e objektivave;

- Rrjeti i ujësjellësit dhe infrastruktura e gjithmbarshme e sistemit të ujësjellësit me përqindje te theksuar e amortizuar dhe ne gjendje te pavolitshme teknike e kondicionale
- Kosto shume e larte financiare për investime ne zvogëlimin e humbjeve teknike
- Mundësitet e limituara buxhetore të kompanisë që determinojnë realizimin e PB në investimet kapitale

### **3. DEPARTAMENTI I UJËRAVE TË NDOTURA**

#### **3.1 Fushëveprimtaria e Departamentit të UN**

Departamenti i UN-ITUN ne fushe veprimtarine e tije perfshinë:

Grumbullimin e ujerave te ndotura per qytetin e Prizrenit, Malisheves Suharekës dhe Dragashit  
permes sistemeve egzistuese dhe sistemeve te reja ne ndertim e siper,

Mirembajtjen e ujerave te ndotura per qytetin e Prizrenit, Malisheves Suharekës dhe Dragashit  
permes sistemeve egzistuese dhe sistemeve te reja ne ndertim e siper,

Konsolidimin e sistemeve egzistuese dhe Planifikimin e sistemeve te reja te kanalizimeve ne  
niveli regional,

Trajtimin e ujerave te ndotura permes Impianteve per trajtimin e ujerave te ndotura te cilat jane  
ndertuar, jane ne ndertim e siper dhe do te ndertoohen ne te ardhmen.

Konsoludimin e impianteve egzistuese dhe planifikimin e impianteve te reja centrale dhe  
parciale ne niveli regional,

Monitorimin dhe konsoludimin e ujerave industriale ne niveli regional,

Garantimin e parametrave te efluantit sipas direktivave dhe udhezimeve ne fuçi te cilat  
percaktojne shkallen e ndotjes e cila lejohet te shkarkohet ne trupat pritese.

Aktualisht jemi duke operuar me ITUN për qytetin e Prizrenit dhe jemi në procedurë të  
menaxhimit edhe me Impiantin e Bukoshit-Suherekë dhe Impiantin e Kukit-Dragash.

#### **3.2 Qëllimet dhe objektivat kryesore**

- Zgjerimin e zonës së shërbimit me sisteme të ujerave të ndotura deri në 80%;
- Zgjerimin e zonës së shërbimit me ndertimin e impianteve të reja për trajtim të ujërave  
të ndotura deri në 20%;
- Sigurimin e shfrytëzimit racional të sistemeve për grumbullim, transportim dhe trajtim  
të ujërave të ndotura;

- Ofrimi i sherbimeve sipas standardeve dhe rregulloreve të percaktuara nga institucionet përkatëse;
- Zbatimi i planeve të mirëmbajtjes ku perfshinë monitorimin, pastrimin dhe kontrollën e sistemit të ujerave të ndotura, të hartuara nga HRJ dhe të miratuara nga ARRU.
- Hartimi i master planeve per sistemet e kanalizimeve ne nivel regjional ne bashkunim me komunat perkatese,
- Zbatimi i kushteve teknike të kycja e konsumatorëve në sistemiun e ujërava të ndotura,
- Përfundimi i Digitalizimi dhe perditesimit i të dhënave për sistemet e kanalizmit në nivel regjional.
- Identifikimi i kycjes së konsumatorëve në sistemin publik të kanalizimit "smoke" testit
- Kontrolli i sistemit të kanalizimit përmes CCTV-ve,
- Modelimet hidraulike për pelljet ujëmbledhëse të ujërave të ndotura,
- Përditësimi i kadastres së ndotësve industrial në nivel regjional,
- Eficienca e energjisë elektrike përmes energjisë së ripërtitshme,
- Avancimi i pjesës së automatizimit si kusht për ngritjen e sistemit të inforacionit,
- Adoptimin e plotë të Rregulloreve të ARRU përfshirë atë të Standardeve Minimale të Shërbimeve, Licencimit, Kartën e Konsumatorëve, Politikën Tarifore të ARRU, dhe të tjera, për sigurimin cilësor të shërbimeve si dhe arritjen e të ardhurave të mjaftueshme që do të mund të mbulojnë shpenzimet operative dhe investimet e domosdomshme vjetore që do të dalin nga Planifikimi i aryeshshëm i Menaxhimit të Aseteve;
- Harmonizimi dhe bashkpunimi i aktiviteteve me donatoret e brendshem dhe të jashtëm në sektorin e ujërave të ndotura, në aspektin investiv dhe legjsilativ.

### 3.3 Aktivitetet e planikuara me qëllim të arritjes së caqeve

Aktivitetet e planikuara janë në fundksion të realizimit të projekteve të parapara në këtë Plan Biznes të cilat do të ndikojnë drejtpëdrejti në realzimin e caqeve:

- Krijimi i grupit punues në bashkëpunim me komunat përkatëse për hartimin e master planeve,
- Hartimi i doracakut i cili prezanton kushtet teknike për kycjen e konsumatorëve në sistemin publik të kanalizimit,
- Identifikimi i konsumatorëve të cilët e ngarkojnë sistemin e kanalizimit pa konsum të ujit nga kompania,
- Formimi i grupit punues për komunikim dhe monitorim të ndotësve industrial,

- Zbatimi i procedurave standarte të operimit (PSO) dhe manualeve përkatëse për operim dhe mirëmbajtje të impianteve në nivel regional,
- Monitorimi i cilesisë së ujit të ndotur në hyrje dhe në dalje të impianateve në nivel regional, sipas standardeve ambientale në fuçi.
- Trajnim i dëshmitave profesionale të qarkut e mbrojtjes së ujëve të nganishme, duke organizuar debateve publike, pjesëmarrje në mediat lokale dhe qendrore, takime punuese me nxenes të të gjitha ciklevit.

### **3.4 Reziqet që mund të ndikojnë në mos arritjen e caqeve**

Reziqet te cilat munde te ndikojne ne mos realizimin e caqeve munde te jene:

- Mos realizimi i investimeve te parapare ne plan biznes,
- Prolongimi i projekteve per shkak te deshtimit te investimeve nga agjencionet te brendshme dhe te jashtme financiare, pasi qe disa nga projektet jane bashkfinancim,
- Jo prioriteti i hartimeve te master planeve nga komunat perkatese,
- Mos zbatimi i rregulloreve teknike te kryesore ne sistemin publik te kanalizimit (kyçjeve ilegale),
- Furnizimi jo i rregullt me energji elektrike per shkak te nderprejeve dhe lujatjeve te tensinit,
- Mungesa ne mbikqyrje te projekteve te perbashketa me komunat perkatese.
- Mungesa e bashkpunimit me palet e interesit,
- Forcat madhore me theks te veçant (vershiemet e mundshme) nga reshjet atmosferike.

### **3.5 Plani investiv**

*Plani i investimeve- në sistemin e kanalizimit dhe impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura*

Plani i investimeve kapitale në sistemin e kanalizimit dhe impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura është hartuar duke ju referuar kërkesave të sektorit, planifikimeve dhe objektivave strategjike të kompanise, si:

- Planin e investimeve afatgjate 2018-2028, si dokument i hartuar në bashkpunim me Qeverin e Kosovës,
- Planeve Zhvillimore Komunale përmes buxheteve të aprovuara komunale,
- Strategjisë Shtetërore të Ujërave të Kosovës, (2017-2036),
- Strategjia për Energji e Republikës së Kosovës (2022-2031),
- Studimit të Fizibilitetit (2011-2035), dokument i hartuar nga Fitchner, financuar nga KfW,

## Përtëritjet e infrastrukturës

Investimet e parapara per Plan Biznesin 2025-2027, konsistojne ne pertritje te infrastruktures pasi qe parashohin ndrrimin e sistemeve jofunkzionle te kanalizimit sidomos ne zonat e vjetra te qyteteve.

Me realizimin e këtyre investimeve do te kemi përmirësimin e sherbimeve me mirembajtje te sistemeve te kanalizimit dhe trajtimit te ujerave te ndotura permes impianteve, konform keresave ambientale ne fuçi,

,shtimin e numrit te konsumatorëve, uljen e shpenzimeve te energjisë elektrike, zgjerimin e shërbimeve etj .

Ne ketë planifikim është paraparë edhe investime ne infrastrukturën e Re ne rrjetin e Kanalizimit, ku kemi ende pjese te qyteteve dhe Fshatrave ku nuk kanë rrjet te kanalizimit dhe derdhja e ujerave te zeza behet pa kurrfarë kriteri - kontolle dhe si rezultat i ketyre ujërave kemi ndotje te ujërave sipërfaqësore, rrezikim te paraqitjeve te epidemive etj.

Ne kuadër te investimeve është paraparë edhe trajtimi (përpunimi ) i ujërave te cilët shkarkohen vend e pa vend ne pjese te Qyteteve dhe Fshatrave. Tani është momenti i fundit qe edhe ne te bëjmë planifikimin e trajtimit te ujërave te Zeza, është edhe kriter i Bashkësisë Evropiane qe ujërat e zeza para se te derdhen ne lum te behet trajtimi paraprak i ujit.

Përpunimi i ujërave te zeza është i kushtueshmen. Ne te ardhmen do te kemi ngritje te çmimit për përpunimin e ujërave te zeza (Kuadër Profesionale , teknologji aplikative etj ). Këto studime do te realizohem me ndihmën e Qeverisë Gjermane permes KfW-se, Bankes Boterore, Kuvendit Komunal dhe Qeverise se Kosovës.

## Rritje e infrastrukturës

Kto investime konsistojne ne rritjen e infrastruktureve pasi qe kan te bejne me furnizimin e makinerive dhe paisjeve te cilat do te sherbejne vetem per konsolidimin e sistemit te kanalizimit dhe impianteve te trajtimit.

Realizimi i këtyre investimeve do te kemi përmirësimin e sherbimeve me mirembajtje te sistemave te kanalizimit dhe trajtimit te ujerave te ndotura permes impianteve, konform kërkesave ambientale ne fuçi,

,shtimin e numrit te konsumatorëve, uljen e shpenzimeve te energjisë elektrike, zgjerimin e shërbimeve etj .

Ne Planin e Biznesit kemi parapare investime ne rritje te infrastruktureve, qe nenkupton zgjerimin e zones se sherbimit permes inkadrimit te sistemeve te reja te kanalizimeve te cilat aktualisht vetmenaxhohen nga komuniteti si dhe zgjerimin e zones se sherbimit me sistemet e reja te kanalizimit dhe trajtimit edhe ne zonat ku menaxhohen nge KRU" HRJ" Sh.a

Duke inkadruar planet e hartuara zhvillimore komunale dhe planet e per gjithshme paralelisht paraqitet nevoja qe tu afrohet sherbimi me grumbullim dhe trajtim te ujerave te ndotura, ne koordinim me keto plane do planifikohen dhe koordinohen investimet kapitale ne sistemin e grumbullimit dhe trajtimit te ujerave te ndotura.

## Mirembajtja e infrastrukturës

Kto investime konsistojne ne Mirembajtjen e paisjeve elektromekanile ne ghith procesin e punes se Impiantit,

ne Planin e Biznesit jane parapare investime ne Mirembajtje te joinfrastruktureve, qe nenkupton ritjen e afatsherbimit te paisjeve elektromekanike gjegjesisht zgjatjen e jetgjatesise ne te gjitha fazat e ciklit ne ITUN.

## Aktivitetet biznesore

Kto investime konsistojne ne mundesine e zbatimit te standardeve minimale te sherbimeve, qe nekupton mundesine e kontrollit dhe pastrimit te sistemit te kanalizimit ne nivel regjional,

ne Planin e Biznesit jane parapare investime ne Aktivite Biznesore, qe furnizimin me Cisterne Thithese-Shtytese e cila sherben per pastrimin gjegjesht debllokimin e pusetave dhe sistemit te kanalizimit ne nivel regjional..

Duke inkuadruar planet e hartuara zhvillimore komunale dhe planet e per gjithshme paralelisht paraqitet nevoja qe tu afrohet sherbimi me grumbullim dhe trajtim te ujerave te ndotura, ne koordinim me keto plane do planifikohen dhe koordinohen investimet kapitale ne sistemin e grumbullimit dhe trajtimit te ujerave te ndotura.

Tabela: 4

INVESTIMET KAPITALE NË SISTEMIN E KANALIZIMIT DHE IMPIANTE PËR TRAJTIM TË UJËRAVE TË NDOTURA NË DEPARTAMENTIN UN- (2025-2027)					
	INVESTIMET NGA MJETET VETANAKE				
Nr	VITET	2024	2025	2026	2027
1	N.J.P. PRIZREN	110,000.00	302,516.00	275,000.00	320,000.00
2	N.J.P- SUHAREKË	10,000.00	0	50,000.00	100,000.00
3	N.J.P. - MALISHEVË	50,000.00	0	50,000.00	100,000.00
4	N.J.P. - DRAGASH	5,000.00	0	30,000.00	50,000.00
	KRU,, HIDROREGJIONI JUGOR" SH..A - PRIZREN	175,000.00	302,516.00	405,000.00	570,000.00

Tabela: 5

	<b>INVESTIMET NGA GRANDET/ DONACIONET</b>				
Nr		2024	2025	2026	2027
1	N.J.P. PRIZREN	4,297,232.00	2,809,097.83	2,190,000.00	3,490,587.00
2	N.J.P.- SUHAREKË	0	400,000.00	442,000.00	450,000.00
3	N.J.P. - MALISHEVË	0	660,000.00	1,774,939.00	1,455,000.00
4	N.J.P. - DRAGASH	0	340,900.00	170,000.00	40,000.00
	KRU., HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN	4,297,232.00	4,209,997.83	4,981,939.00	6,005,587.00

Sa i perket investimeve te planifikuara nga Komunat per ujerat e ndotura, i kemi paraiqtur si projekte mirpo nuk kemi te nenshkruara marreveshje te bashkefinancimit me Komunat perkatese.

Realizimi i investimeve kapitale per vitin 2024:

Investimet me mjete vetanake jane ne procedure dhe pritet te realizohen deri ne masen 100%,

Projekti me nr. 15 eshte nenshkruar kontrata me kontraktorin dhe jemi ne fazen e furnizimit me materialin perkates. Projektet me nr. 14 dhe 16 jane inicuar nga njesia kerkuese DUN dhe te njejtat jane ne proces te prokurimit dhe projekti me nr. 17 eshte inicuar dhe jane duke vazhduar procedurat e prokurimit,

Investimet nga grantet dhe donacionet poashtu jane ne procedure, aktualisht jemi duke realizuar projektin e financuar nga KfW "Reabilitimi i sistemit te kanalizimit per qytetin e Prizrenit", ky projekt ka filluar ne Nentor te vitit 2022 dhe pritet te perfundoj ne fund te muajit Nentor te vitit 2024, deri me tanji jane realizuar rreth 80% punimeve.

Per kete projekt eshte ne dispozicion raporti i vecant.

Projektet me mjete vetanake per vitin 2025, 2026 dhe 2027 jane bashkengjitur me aneks te vecant ne EXCEL, dhe investimet per vitin 2025 perputhen me investimet ne Aplikimin Tarifor per vitin 2025.

Projektet per vitin 2025 ne Plan Biznes, korespondojne me projektet e Plan Biznesit per Aplikim Tarifor per vitin 2025.

## TRAJTIMI I UJIT TË NDOTUR – m3- 2025-2027

*Tabela: 6*

		2025-2027			
No.	Të dhënat	K.R.U „HIDROREGJONI JUGOR“ SH.A - PRIZREN			
		2024	2025	2026	2027
		m3	m3	m3	m3
	<b>NJËSIA PUNUESE</b>				
1	PRIZREN	3,660,555	3,731,382	3,783,280	3,784,340
2	SUHAREKË	94,000	94,000	94000	94000
6	<b>TOTAL</b>	<b>3,754,555</b>	<b>3,825,382</b>	<b>3,877,280</b>	<b>3,878,340</b>

Ne impiantin biologjik te Bukoshit NJO Suhareke, nuk kemi bere shpenzime per trajtimin e ujit te ndotur, por si vellim uji i ndotur eshte trajtuar.

Te dhenat per ujin e trajtuar te Impianti i Suharekes eshte i vleresuar, vleresimi eshte bere ne raport me numrin e banoreve ekuivalent te cileve u trajtohet uji i ndotur.

### *Shpenzimet e Operimit dhe mirembajtjes ne ITUN*

Shpenzimet e operimit dhe mirembajtjes jane optimizuar ne funksion te shkalles se ndotjes ne hyrje te impiantit, te njejtat pasqyrohen te Departamenti Fonanciar. Gjate vitit 2024, kemi patur me pak shpenzime operuese dhe te mirembajtjes per shkak se kemi zvogeluar riqarkullimin e ujit nga sedimentimi perfundimtar, jemi duke operuar vetem me nje pompe qendrore ne hyrje te sistemit te trajtimit si dhe nuk kemi aktivizuar pjesen mekanike te dehidrimtit te llumit pasi qe llumi pas trashjes-stabilzimit dirpekt shkarkohet ne shtreterit per tharje per stabilzim te metejshem. E njejta gje eshte planifikuar edhe per vitet 2025-2027.

#### 4. DEPARTAMENTI KOMERCIAL

Departamenti Rajonal për Konsumatorë bënë organizimin, koordinimin dhe monitorimin e aktiviteteve në realizimin e shërbimeve me konsumatorët. Ky departament me sektionet e veta synim që në vazhdimi të rrisë përformancën e shërbimeve për konsumatorët në kuadër të përgjegjësive të veta si departament. Ai siguron komunikimin të ndërsjellët me të gjitha departamentet tjera, ndërmerr të gjitha hapat e nevojshme që të gjitha ankesat dhe kérkesat e konsumatorëve ti distribuoj në departamentet dhe sektionet tjera në domenin e të cilave bijnë përgjegjësit për realizmin e atyre kérkesave/ankesave të konsumatorëve. Nëpërmes lexuesve në teren bëjnë leximin e ujëmatësve në teren tek konsumatorët, ku njëkohësisht edhe bëjnë shtypjen e faturave në teren duke i dorëzuar këtë faturë konsumatorit. Organizon punën në sektionin e arkave ku konsumatorët bëjnë pagesat e faturave të shërbimeve të ujësjellësit. Të hollat e mbledhura nga stafi i këtij sektioni dorëzohen në arkën kryesore të kompanisë ose në llogaritë e kompanisë. Nëpërmes ekipeve të inspektoratit, organizon kontolle rutinë dhe të planifikuara tek konsumatorët si: leximin e ujëmatësve, lidhjet e paautorizuara, identifikon konsumatorët ilegalë bën legalizimin e tyre duke i zbatuar vendimet dhe rregulloret e brendshme të kompanisë, bënë inkasimin e borxheve të vjetra, shkycjen për mos pagesa të shërbimeve si dhe punë të tjera me të cilët ngarkohen ky sektion. Njëkohësisht, pranon raportet e tyre dhe ndërmerr veprime të menjëherëshe dhe urgjente. Pranon kérkesat për kryje të reja, mbledh dokumentacionin e nevojshëm dhe i dorëzon ato në departamentin për procedurë të mëtutjeshme.

Departamenti me konsumatorë është departament i cili organizon dhe udhëheq punën me shërbimin me konsumatorë nëpër Njësit Operative në Suharekë, Malishevë dhe Dragash. Nëpërmes udhëheqësve me konsumatorë koordinon dhe monitoron punët në sektionin e faturimit, inkasimin përmes arkave, lexuesve në teren, inspektoratit dhe shkyçjes. Gjithashtu udhëheq procedurat për zgjidhjen e kontesteve me konsumatorë, koordinon aktivitetet me Komisionin për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve të Autoritetit Rregulator për Shërbimet e Ujit (ARRU). Pranon ankesat, kérkesat komerciale të konsumatorëve, i shqyrton në pajtim me politikat, procedurat dhe rregulloret në fuqi. Për punët dhe aktivitetet e veta ky departament i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

Kompania është përfundimisht e orientuar në plotësimin dhe rritjen e kënaqsh mërisë së konsumatorëve të saj, përkundër natyrës monopolistike të biznesit që kryen. Siguron transparencë dhe bashkëpunimit me të gjithë arteret e sektorit të ujit në Kosovë dhe më gjerë.

Departamenti me Konsumatorë edhe më tutje do të rritë performancën e saj në shërbimet që ofron në kuadër të përgjegjësive që ka në raport me konsumatorët si: dhënia e mundësive të shumta për pagesën e shërbimeve nga konsumatorët, qasjen elektronike në kartelën e tyre, avancimin e softverit, përditësimin e të dhënave të konsumatorëve, pranimin dhe shqyrtimin sa më efikas dhe brenda afateve kohore të ankesave të konsumatorëve.

#### *4.1.1 Parashikimi i rritjes së numrit të konsumatorëve*


Të tabelat vijuese mund të shihni parashikimin e rritjes se numrit të konsumatorëve të ndara në tri kategori: amvisëri, biznese dhe institucionale. Tabelat në vazhdim paraqesin rritjen e numrit të konsumatorëve dhe kërkesës për ujë në zonën aktuale të shërbimit si rezultat i lidhjeve të reja dhe konsumatorëve të paautorizuar.

#### *4.1.2 NUMRI I KONSUMATORËVE 2025– 2027*

*Tabela 7*

2025-2027						
No.	Të dhënat	2023	2024	2025	2026	2027
1	Shtëpiak	52,035	54,004	56,517	61,248	63,575
2	Ndryshimi		1,969	2,513	4,731	2,327
3	Ndryshi. %		3.78%	4.7%	8.4%	3.8%
4	Kome.-Indu.	6,585	6,830	7,064	7,329	8,301
5	Ndryshimi		245	234	265	972
6	Ndryshi. %		3.72%	3.4%	3.8%	13.3%
7	Institucional	343	357	363	380	384
8	Ndryshimi		14	6	17	4
9	Ndryshi. %		4.08%	1.7%	4.7%	1.1%
10	TOTAL	58,963	61,191	63,944	68,957	72,260
11	Ndryshimi		2,228	2,753	5,013	3,303
12	Ndryshi. %		3.8%	4.5%	7.8%	4.8%

## NUMRI I KONSUMATORËVE- 2025-2027




Rritja e numrit të konsumatorëve kryesisht është planifikuar të bëhet me konsumatorë të rinjë të cilët kryesisht do të bëhen nga pëlqimet për kyqje në rrjet, legalizimet si dhe planifikimi i marrjes në menaxhim të zonave rurale. Ky numër i konsumatorëve do të ketë ndikim në rritjen e sasisë së ujit të faturuar.

### ***3.1.3 FATURIMI m3 - 2025 – 2027***

Tabela:8

2025-2027						
No.	Të dhënat	2023	2024	2025	2026	2027
1	Shtëpiak	6,778,431	7,416,273	8,299,134	9,108,978	9,670,209
2	Ndryshimi		637,842	882,861	809,843	561,231
3	Ndry. %		9.4%	11.9%	9.8%	6.2%
4	Kome.-Indu.	771,192	799,853	839,094	911,126	1,039,369
5	Ndryshimi		28,661	39,241	72,032	128,243
6	Ndry. %		3.7%	4.9%	8.6%	14.1%
7	Institucional	521,516	548,899	578,243	638,023	637,348
8	Ndryshimi		27,383	29,344	59,780	(675)
9	Ndry. %		5.3%	5.3%	10.3%	-0.1%
10	<b>TOTAL</b>	8,071,139	8,765,025	9,716,471	10,658,126	11,346,925
11	Ndryshimi		693,886	951,446	941,655	688,799
12	Ndry. %		8.6%	10.9%	9.7%	6.5%




- Gjatë periudhës 3 vjeqare është planifikuar edhe një rritje e sasisë së faturuar të ujit. Kjo rritje është planifikuar të realizohet nga konsumi i konsumatorëve të rinjë që do të regjistrohen, identifikimi dhe shkyqja e lidhjeve të paautorizuara e të cilat do të reflektojn rritjen e konsumit të autorizuar, ndërrimi i ujëmatësve të amortizuar dhe që nuk kontojn etj.

#### 4.1.4 Planifikimi i Faturimit € 2025-2027

Tabela:9

2025-2027						
No.	Të dhënat	2023	2024	2025	2026	2027
1	Faturimi-€	5,465,127.98	5,792,140.33	6,636,049.95	7,259,606.34	7,725,609.31
2	Total- Shtë.	4,119,857.06	4,444,223.84	5,227,308.89	5,708,809.63	6,065,035.86
3	Ndryshimi		324,366.78	783,085.05	481,500.73	356,226.23
4	Ndry. %		7.9%	17.6%	9.2%	6.2%
5	Total- kome.	871,448.56	903,784.09	897,033.35	986,930.52	1,094,014.78
6	Ndryshimi		32,335.53	(6,750.75)	89,897.17	107,084.26
7	Ndry. %		3.7%	-0.7%	10.0%	10.9%
8	Total-Inst.	473,822.36	444,132.40	511,707.71	563,866.20	566,558.68
9	Ndryshimi		(29,689.96)	67,575.31	52,158.49	2,692.48

10	Ndry. %		-6.3%	15.2%	10.2%	0.5%
11	Të tjera	50,832.26	48,723.92	26,740.00	49,740.00	32,760.00
12	Total	5,515,960.24	5,840,864.25	6,662,789.95	7,309,346.34	7,758,369.31
13	Ndryshimi		324,904.01	821,925.70	646,556.39	449,022.97
14	Ndry. %		5.9%	14.1%	9.7%	6.1%




- Faturimi në euro është planifikuar sipas tarifave egzistuese e shumëzuar me sasinë e planifikuar të ujit në m<sup>3</sup>. Faturimi është planifikuar sipas tarifave të tri kategorive të konsumatorëve të aprovuara nga ARRU.
- 

#### 4.1.5 Planifikimi i Arkëtimit € 2025-2027

Tabela:10

2025-2027						
No.	Të dhënat	2023	2024	2025	2026	2027
1	Total- Shtëpiak	4,178,475.75	4,513,074.68	4,965,943.45	5,480,457.24	5,852,759.60
2	Ndryshimi			452,868.77	514,513.79	372,302.36
3	Ndry. %			10.0%	10.4%	6.8%
4	Total-Komercial-Industrial	851,200.99	969,683.82	897,033.35	986,930.52	1,094,014.78

5	Ndryshimi			(72,650.47)	89,897.17	107,084.26
6	Ndry. %			-7.5%	10.0%	10.9%
7	Total Institucional	445,770.13	424,637.78	511,707.71	563,866.20	566,558.68
8	Ndryshimi			87,069.93	52,158.49	2,692.48
9	Ndry. %			20.5%	10.2%	0.5%
10	Total - ujë	5,175,446.87	5,907,396.28	6,374,084.51	7,031,253.96	7,513,333.06
11	Ndryshimi			467,288.23	656,569.45	482,079.10
12	Ndry. %			7.9%	10.3%	6.9%
13	Te tjera	46,907.35	41,875.75	52,420.00	49,740.00	32,760.00
14	Ndryshimi			10,544.25	(2,680.00)	(16,980.00)
15	Ndry. %			25.2%	-5.1%	-34.1%
16	TOTAL	5,522,354.22	5,949,272.03	6,427,104.51	7,080,993.96	7,546,093.06
17	Ndryshimi		426,917.81	477,832.48	653,889.45	465,099.10
18	Ndry. %		7.7%	8.0%	10.2%	6.6%



- Inkasimi është planifikuar duke u bazuar në trendin rritës të viteve të mëparshme , duke i shtuar mundësitet e arkëtimit nga konsumatorët e rindë. E gjithë kjo pasqyron një rritje të inkasimit nga viti në vit e që mbulon shpenzimet operative dhe investimet e KRU " Hidroregjioni Jugor" SHA

## *Departamenti Komercial*

### **Objektivat kryesore**

- Të ofrojë të gjitha shërbimet për konsumatorët sipas të gjitha standardeve të shërbimeve.
- Rritja e numrit të konsumatorëve në bazën e të dhënave të konsumatorëve me të dhëna të reja për konsumatorët si: modifikime dhe ndryshime të emrit, regjistrim të pronës së konsumatorëve, kategorive etj.
- Të marr në menaxhim zona të reja rurale apo edhe lagje të caktuara në qytet në të cilat operon duke e zgjeruar zonën e shërbimit e me këtë edhe rritjen e sasisë së faturuar të ujit në  $m^3$ .
- Të arrijë të gjitha caqet e planifikuara në rritjen e faturimit dhe arkëtimit.

### **4.2 Aktivitetet kryesore të planifikuara për arritjen e objektivave nga Departamenti Komercial**

- Të lexoj rregullisht ujëmatësit për ujin e shpenzuar
- Të faturoj dhe shpërndaj faturat për konsumatorët rregullisht
- Të legalizoj konsumatorët të cilët veç janë kyçur në shërbim sipas procedurave për legalizim
- Azhurnimi i bazës së konsumatorëve me të dhëna të reja për konsumatorët si: ndryshim të emrit, ndryshim të pronës së konsumatorëve, kategorive etj.
- Të kërkoj nga konsumatorët inkasimin e faturave të shpërndara për konsumatorët
- Të inicioj raste në përmbarim për konsumatorët të cilët nuk kanë paguar shërbimet e ujësjellësit
- Të marr në menaxhim zona të reja rurale apo edhe lagje të caktuara në qytet në të cilat operon duke e zgjeruar zonën e shërbimit e me këtë edhe rritjen e sasisë së faturuar të ujit në  $m^3$ . Të gjithë këta konsumatorë do të faturohen sipas urdhëresave tarifore të lëshuara nga ARRU.
- Rritje e aktiviteteve të shërbimit të lexuesve në leximin e ujëmatësve dhe dërgimin e faturave me rregull tek konsumatorët

- Rritje e aktivitetit të ekipeve të inspektoratit në rritjen e presionit tek konsumatorët në pagesën e shërbimeve të ujësjellësit
- Dërgimi i rasteve në përmbarim të konsumatorëve të cilët nuk l përgjigjen pagesave të mujore të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit
- Dërgimi i mesazheve dhe thirrjet telefonike te shpeshta te konsumatorët të cilët kanë ri programuar borxhet e tyre.
- Marrja e masave ligjore ndaj kyçeve të paligjshme.
- Përmirësimi i raporteve Konsumatorë-Kompani
- Përgatitja dhe realizimi i fushatave të vetëdijesimit të popullatës duke bashkëpunuar edhe me institucionet tjera (Kuvendin Komunal, SHPK-ne, Gjykatat dhe Mediat).

#### *4.3 Gatishmëria për të paguar*

Tani pagesat e faturave të shërbimeve të ujit paguhen në mënyra dhe forma të ndryshme, ku konsumatorëve i është dhënë mundësia e pagesës në të gjitha bankat komerciale, institucione mikrofinanciare, postë dhe në arka tona në secilën njësi operative. Spotelet për pagesa të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit aktualisht funksionojnë nëpër objektet e kompanisë, ne zona të caktuara në qytet dhe në disa fshatra, në objektet e Kuvendeve Komunale në Prizren dhe Malishevë, planifikohet që të zgjerohet edhe nëpër në zona tjera , ku konsumatorëve do të ju ofrohet mundësi për pagesën e shërbimeve të tyre, njëkohësisht në këto sportele konsumatori do të ketë mundësi që të shpreh ankesat e tyre për shërbimet tona. Për borxhet e akumuluara të konsumatorëve do tu ofrohet ri programimi i borxhit si dhe pagesa e tij në këste mujore.

Planifikohet të organizohen edhe kampanja të vetëdijesimit të konsumatorëve lidhur me mënyrat e pagesës së shërbimeve ku njëkohësisht pritet edhe rritje e inkasimit nga këto kampanja.

##### *4.3.1 Trendët e kërkesave më të shpeshta të konsumatorëve*

Një ndër objektivat kryesore e kompanisë për vitin 2023-2025 është rritja e të hyrave, respektivisht rritja e arkëtimit nëpërmjet faturimit të matur të konsumatorëve. Kompania është e orientuar që të jetë financiarisht e vetë qëndrueshme dhe e aftë ti kryej të gjitha shërbimet e domosdoshme.

Në këtë drejtim janë paraparë masa konkrete të cilat do të rezultojnë në rritjen e arkëtitimit;

- Implementimi i plotë i kodit të veshjes dhe mirësjelljes të stafit te KRU "Hidroregjioni Jugor" ndaj konsumatorëve
- Ndërrimi i terreneve të inkasantëve për evitim të familjarizimit me konsumator
- Trajnim i stafit, me qëllim të përmirësimit të sjelljeve dhe kontakteve me konsumatorë
- Funksionalizimi dhe profesionalizimi i Zyrës Pritëse për Konsumatorë në secilën njësi operative
- Shqyrtimi i drejtë, i paanshëm dhe në afat sa më të shpejtë i të gjitha ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve
- Leximi i rregullt dhe i saktë i ujëmatësve duke i penalizuar inkasantët për mos lexim
- Faturimi sipas shpenzimit (eliminimi i faturimit paushall)
- Marrja e masave ligjore sipas ARRU-së (procedurat e shkycjes) për konsumatorët borxhlinj
- Arkëtimi i mjeteve përmes përbartuesve privat
- Forcimi i mëtejmë ekipeve të inspektoratit dhe ekipeve për shkycje me paisje të nevojshme në teren
- Zgjidhja e rasteve sociale në bashkëpunim me institucionet tjera relevante

#### *4.3.2 Kërkesat e performancës së shërbimit ndaj konsumatorëve*

Avansimi i shërbimeve në Zyrën Pritëse për Konsumator, do të mundësoj që me rastin e paraqitjes në zyrës e kompanisë për ankesën dhe kërkesën që ka, ta pret personi zyrtar i kompanisë dhe të ja bëjë regjistrimin e ankesës, gjithashtu kjo zyre do të ketë numrit te telefonit që do të jetë në dispozicion 24 orë për konsumatorin ku do ti lajmëroj të gjitha ankesat dhe kërkesat e tij. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Konsumatorëve do të administrojë të gjitha ankesat dhe kërkesat e konsumatorëve dhe në një afat sa më të shkurtër do ti shqyrtojë ato dhe do ti përgjigjet konsumatorëve.

Disa shërbime si: dërgimi i faturës ne emali te konsumatorit, plotësimi i ankesës online, mundësia e shikimit të kartelës online tashmë veç ju kanë ofruar konsumatorëve. Këto shërbime konsumatorët do ti marrin pas regjistrimit të tyre në aplikacionin e vendosur online në ueb faqen e Kompanisë.

Me qëllim të zbatimit dhe shqyrtimit të ankesave të konsumatorëve do të plotësohen dhe të organizohen trajnime të stafit të shërbimit me konsumatorë.

Me përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve kompania planifikon që të arrijë edhe përmirësimin e performancave sidomos në rritjen e numrit të konsumatorëve, pasivizimin e konsumatorëve fiktiv, rritjen e sasisë së faturimit, zvogëlimin e keqpërdorimeve, zvogëlimin e

lidhjeve ilegale, dhe përmirësimin e inkasimit që është një ndër objektivat kryesore dhe të domosdoshme të kompanisë.

## *4.4 Plani operacional*

### *4.4.1 Planifikimi i zgjerimit të shërbimit*

Departamenti komercial krahas politikës zhvillimore që e ka KRU "Hidroregjioni Jugor" sha në zgjerimin e zonës së shërbimit edhe në zonat rurale që janë jashtë menaxhimit të KRU "Hidroregjioni Jugor" sha, planifikon edhe në rritjen e stafit në këtë shërbim në të gjitha njësit operative si : Arkatar, lexues dhe punëtor në inspektorat.

Ne bashkëpunim me Komunat me nënshkrimin e memorandumit te mirëkuptimit jemi pajtuar qe fshatrat te cilat janë te gatshme dhe plotësojnë kushtet teknike dhe ekonomiko financiare mund të kalojnë nën shërbimin e Kompanisë.

### *4.4.2 Aktivitetet kryesore të planifikuara për arritjen e objektivave*

- Të furnizoj konsumatorët ekzistues
- Të kyç në shërbim konsumatorët e rinjë dhe të legalizoj konsumatorët të cilët veç janë kyçur në shërbim
- Rifreskimin e bazës së konsumatorëve me të dhëna të reja për konsumatorët si: ndryshim të emrit, ndryshim të pronës së konsumatorëve, kategorive etj.
- Të marr nën menaxhim zona të reja rurale apo edhe lagje të caktuara në qytet në të cilat operon duke e zgjeruar zonën e shërbimit edhe në zonat rurale

### *4.4.3 Aktivitetet kryesore për zvogëlimin e UPF-së*

- Të bëhen kontrolla dhe inspektimi rutinë dhe të planifikuar nga ekipet e inspektoratit në nivel rajonal diku 100-120 shkyje ilegale për çdo muaj, mbi 1000 lidhje ilegale vjetore.
- Këto inspektimi do të bëhen për zbulim të lidhjeve pas orës, manipulime me ujëmatës, kontrolli më të leximit të ujëmatësve etj.
- Të legalizohen të gjithë konsumatorët sipas procedurës së legalizimit.

- Të regjistrohen të gjithë konsumatorët të cilët kanë marrë pëlqim për kryje në shërbime.
- Zvogëlimi i konsumatorëve pa konsum.

#### ***4.4.4 Rreziqet që mund të ndikojnë në mos arritjen e objektivave***

- Pamundësia e marjes në menaxhim të zonave të reja të shërbimit
- Zbulimi i vonshëm i konsumatorëve të cilët janë kyç në rrjet
- Mungesa e vullnetit të komunitetit të zonave rurale në hyrje nën menaxhim të KRU "Hidroregjioni Jugor" sha

## **5. DEPARTAMENTI RAJONAL I FINANCAVE**

### **5.1 Analiza e shpenzimeve**

Sa i përket analizës së shpenzimeve Kompania "Hidroregjioni Jugor" SH.A. do të financojë në mënyrë kualitative shpenzimet operative, të mirëmbajtjes.

Të gjitha shpenzimet, edhe ato që i përkasin stafit do të orientohen në funksionimin normal të të gjitha segmenteve të punës në ujësjellës dhe prioritet kryesor është arritura e objektivave që janë përcaktuar në pjesën hyrëse të këtij Plani te Biznesit.

Një aktivitet tjetër në këtë drejtim është se kompania do të përqendrohet në kursimin e energjisë elektrike ne disa stacione te pompimit, në ulje të shpenzimeve të mirëmbajtjes në rrjet etj.


Kompania do të angazhohet që te zvogëlojë edhe shpenzime tjera, aty ku është e mundur ne mënyrë që me të hyrat e arkëtuara t' i mbulojë shpenzimet e rregullta operative, shpenzimet e kompensimit për punën jashtë orarit, shpenzimet për palët e treta etj.

## 5.2 Planifikimi i shpenzimeve – 2024- 2026

### Shpenzimet Totale (me impiant)

Tabela:11

2025-2027						
No.	Të dhënat	JANAR-DHJETOR 2023	JANAR-DHJETOR 2024	JANAR-DHJETOR 2025	JANAR-DHJETOR 2026	JANAR-DHJETOR 2027
1	Total Shpenzimet Operative	4,689,047.15	4,849,101.31	5,143,966.86	5,457,520.10	5,648,331.61
2	Pagat	2,879,712.25	2,990,602.90	3,283,638.38	3,561,612.38	3,657,828.51
3	Rryma elektrike	1,016,147.70	1,045,058.56	1,048,699.25	1,048,699.25	1,101,134.22
4	Shpen. e derivateve	117,716.28	114,534.83	113,170.80	113,170.80	118,829.34
5	Mirem. dhe riparimet	185,992.06	238,437.44	220,000.00	235,000.00	246,750.00
6	Mirem. e automjeteve	79,655.94	103,889.67	105,000.00	110,000.00	115,500.00
7	Shpen.e taksave	109,390.16	115,451.57	113,037.67	123,037.67	128,689.55
8	Kemikaliet	40,089.69	25,853.63	26,420.76	32,000.00	33,600.00
9	Shpenzimet e tjera	260,343.07	215,272.71	234,000.00	234,000.00	246,000.00
10	Ndryshimi		160,054	294,866	313,553	190,812
11	Ndryshimi ne %		3.4%	6.1%	6.1%	3.5%



### *5.3 Arsyeshmëria e shpenzimeve – 2025- 2027*

Shpenzimet pagave per vitin 2025, planifikohen te rriten, duke shtuar punëtorë, sipas kërkesave dhe arsyetimeve të dhëna nga departamentet përkatëse me 30 punëtorë dhe atë, duke llogaritur edhe pozitat e lira, të cilat janë duke u shfrytezuara me ushtrues detyre. Rekrutimi i tyre do të fillojë nga muajin mars 1 viti 2025, duke vazhduar me plotësimin e vendeve të punës deri në fund vit.

Gjithashtu, sipas kërkesave dhe arsyetimeve nga departamentet përkatëse, në 2026 planifikohen të mirren edhe 30 punëtorë dhe në vitin 2027, 16 punëtorë.

Vlen theksohet se, deri në vitin priten të pensionohen diku 31 punëtorë. Pra është pothuajse e domosdoshme rekrutimimi i punëtorëve të rinjë, për një operim sa më të mirë të kompanisë.

Nga janari 2025, eshte planifikuar te kete një rritje linear te pagave prej 50€. Kjo rritje do te kete impakt financiar ne shume totale vjetore prej 207.900 €

Në pozicionin e shpenzimeve të përgjithëshme të kompanisë nuk janë të përfshira edhe detyrimet kontigjente, të cilat paraqesin edhe rreziqe për Kompaninë.

Obligimet ndaj KEK-ut të cilat obligime janë me vendim Gjykate, por që kemi marrëveshje për pagim me këste.

Viti 2025 ; 1 – Kësti mujor për KEK-un  $10,064.00 \times 12 = 120,768.00$

## 6. TREGUESIT KRYESOR TË PERFORMANCES – 2025-2027

Tabela:12

Treguesit e Performancës	[Njesia]	2025-2027				
		2023	2024	2025	2026	2027
Uje i faturuar-si perqindje	%	25.8%	27.8%	31.02%	33.61%	35.70%
Uje i pafaturuar-si perqindje	%	74.24%	72.16%	68.98%	66.39%	64.30%
Norma e arketimit - e per gjithshme	%	100.19	101.99	96.06	96.85	97.25
Norma e arketimit - Amviserite	%	101.42	101.55	95.00	96.00	96.50
Norma e arketimit - Komercial-Industrial	%	97.68	107.29	100.00	100.00	100.00
Norma e arketimit -Institucional	%	94.08	95.61	100.00	100.00	100.00
Norma e Mbulimit operativ	numer	1.18	1.23	1.25	1.30	1.34

1.26

Treguesit e Performancës	[Njesia]	2023	2024	2025	2026	2027
		€	€	€	€	€
Te hyrat	€	5,522,354	5,949,272	6,427,105	7,080,994	7,546,093
Shpenzimet	€	4,689,047	4,849,101	5,143,967	5,457,520	5,648,332
Keshi	€	833,307	1,100,171	1,283,138	1,623,474	1,897,761
Mbulimi operativ	%	1.18	1.23	1.25	1.30	1.34

## 7. Analiza SWOT

Faktorët e mbrendshmëri (attributet e organizatës)	Të dobishme (për arritjen e objektivave)	Të dëmshme (për arritjen e objektivave)
	<p><b>Përparësitë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Uji si element i domosdoshëm për jetë</li> <li>- Burimet e bollshme për ujë cilësor dhe kualitativ te pijes</li> <li>- Staf me përvojë shumëvjeçarë</li> <li>- Gjendje e përmirësuar e infrastrukturës elektro-hidraulike e stacioneve pompuese.</li> <li>- Automatizimi dhe Eficiencia optimale e pajisjeve</li> <li>- Kalibrimi i licencuar për ujëmatës</li> <li>- Laboratori i akredituar për cilësi dhe analiza te ujit</li> <li>- TI e avancuar për programe aplikative për GIS, MMS, MMA, MIA, Bench Marking, etj</li> <li>- Trend në rritje të faturimit dhe arkëtimit nga viti në vit</li> <li>- Aplikim i metodologjive të reja në faturim dhe pagesa të shërbimeve</li> <li>- Treg monopoli në ofrimin e shërbimeve</li> <li>- Sistem i integruar i sistemit informativ financiar</li> </ul>	<p><b>Dobësitë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rrjetat e ujësjellësit dhe kanalizimit te amortizuara dhe ne gjendje te pavolitshme teknike e kondicionale.</li> <li>- Prezenca e theksuar e materialeve azbest cement e celik te amortizuar</li> <li>- Humbjet e mëdha teknike te ujit te pijes</li> <li>- Mosharmonizimi dhe mosrespektimi i kriterieve dizajnuese e projektuese teknike gjate investimeve komunale ne infrastrukturën ujore.</li> <li>- Mungese e kuadrove profesional ne sektor specifik dhe trajimeve ne avancime profesionale.</li> <li>- Largimi i kuadrove dhe emigrimi i shtresës potenciale për pune.</li> <li>- Legjislatura qe pjesërisht mbulon këtë fushë veprimtari dhe mos zhuritet i organeve te drejtësisë për ndjekjen e keqpërdoruesve dhe shkelësve te ligjit</li> </ul> <p>➤ Kompania ka planifikuar qe me njete vetanake por edhe me ndihmën e donatoreve te ndërrojë rrjetin ne vazhdimësi, varësisht nga mundësia financiare. (Shiko shtojcën e investimeve)</p> <p>➤ Përmirësimi i bashkëpunimit me Investitorët do te evitoje dobësitë ne investimet ne infrastrukturë</p> <p>➤ Me përmirësimin e kushteve te punës si dhe nivelimin e te ardhurave personale planifikohet qe Kompania te jete një mundësi me e mire për te aplikuar nga stafi profesional i profileve te ndryshme</p>

Mundësítë	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Projekt dokumentacionet e gatshme investive</li> <li>- Studimet fisibile dhe auditet e realizuara nga institutet kredibile dhe stafi inxhinierik i Kompanisë.</li> <li>- Infrastrukturë e qëndrueshme hidro - elektro teknike dhe makinerike</li> <li>- Staf i profesionalizuar në sektorë per funksionim dhe operim efikas</li> <li>- Përgjegjësi dhe përkushtim i stafit ne realizmin e objektivave te punës</li> <li>- Tarifa të rregulluara nga ARRU</li> <li>- Infrastrukturë të qëndrueshme për ofrimin e shërbimeve</li> <li>- Zgjerim i vazhdueshëm i biznesit dhe i shërbimeve te konsumatorë të rinjë</li> <li>- Staf i profesionalizuar në sektorë dhe shërbime të caktuara</li> <li>- Përkushtim i stafit në sfida dhe përgjegjësi të reja të punës</li> <li>-</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zvogëlimi drastik i kapaciteteve ujore si rezultat i kushteve te pavolitshme atmosferike ne periudha kritike.</li> <li>- Pamundësia financiare për realizimin e projekteve kruciale investive sipas PB dhe planifikimeve tjera për funksionim e operim efikas.</li> <li>- Pamundësia e instalimit, ndërrimit e kalibrimit te te gjithe ujëmatësve prodhues, zonal e te konsumatorëve sipas kriterieve rregullative e ankesave.</li> <li>- Efektet pandemike dhe efektet e ngjashme te natyrës brenda dhe jashtë dimensioneve njerëzore</li> <li>- Pamundësia teknike e leximit të të gjithë ujëmatësve brenda muajit</li> <li>- Dyert e myllura dhe që nuk hapen nga konsumatorët në vazhdimesi</li> <li>- Emigrimi i njerëzve do të ndikoj në ulje të faturimit</li> <li>- Gjendja ekonomike dhe financiare e dobët e familjeve.</li> <li>-</li> <li>- Kompania ka planifikuar qe ne raste nevoje te ve ne funksion burime alternative te furnizimit (stacioni i filtrimit me kapacitet mbi 100 l/sec.</li> <li>- Rritja e bashkëpunimit me donatore për rritjen e investimeve kapitale</li> <li>- Vendosja e pusetave dhe ujëmatëseve ne vende ku Kompania do te ketë qasje te përhershme për kontolle dhe lexim.</li> </ul>

## **8. PLANI I ZHVILLIMIT TË STAFIT**

Raportet midis stafit do të përcaktohen në bazë të Rregullores së organizimit të brendshëm të Ujësjellësit, ndërsa kryerja e detyrave të punës do te bëhet në varshmëri të përshkrimit detal të secilit vend të punës veç e veç. Në bazë të këtij përshkrimi do te përcaktohen edhe kushtet minimale (përgatitja profesionale, përvoja e kaluar në punë të ngjashme apo të përafërt, shkathtësitet tjetra të veçanta për lidhjen e marrëdhënies së punës, shkalla e përgjegjësive të punëtorëve, niveli i pagesës si dhe hierarkia e dhënies së përgjegjësisë). Me qëllim të përbushjes së obligimeve ndaj konsumatorëve, respektivisht mirëmbajtjes së rrjetit kompania ka paraparë që të rrisë numrin e punëtorëve për vitin 2023-2025 varësisht nga numri i fshatrave që do të merren në menaxhim. Këta punëtorë do të jenë të angazhuar kryesisht në shërbimin e inkasimit dhe kontrollës në zonat e reja të shërbimit

Stafi i punësuar do te jetë heterogjen:

- Nga aspekti i përgatitjes profesionale;
- Nga aspekti i shkathtësive dhe racionalitetit në punë;
- Nga aspekti i përfaqësimit nacional;
- Nga aspekti i përfaqësimit gjinor;
- Nga aspekti i përfaqësimit fetar;
- Nga aspekti social etj.

### **7.1 NUMRI I PUNËTORËVE**

#### **7.1.1 Planifikimi i numrit të punëtorëve 2025-2027**

Tabela:13

Nr.	VITI	2023	2024	2025	2026	2027
	<b>NJ.PUNUESE</b>					
1	<b>PRIZREN</b>	239	230	259	288	303
2	<b>SUHAREKË</b>	35	38	39	39	39
3	<b>DRAGASH</b>	16	16	16	17	18
4	<b>MALISHEVË</b>	35	32	32	32	32
5	<b>HIDROREGJIONI</b>	325	316	346	376	392
6	<b>NFRYSHIMI</b>		-9	30	30	16
7	<b>NDRSHI. - %</b>		-2.77%	9.49%	8.67%	4.26%

*Rritja e numrit të punëtorëve*

*2025-2027*

Tabela:14

NR	Përshkrimi i vendeve te punë	Nr. i punëtorëve të rinjë		
		2025	2026	2027
1	Inxhinier i Hidroteknikës (UPF)	1	1	1
2	Inxhinier i Elektroteknikës		1	1
3	Detektues (UPF)	1	1	1
4	Kalibrues në Servis të Ujematësve	1		
5	Punëtor Fizik	4	5	4
6	Vozitës i Makinave të Rënda		1	1
7	Vozitës (Kategoria C)		1	1
8	Kujdestar - Mirëmbajtës i Pompave (Nashec)	1		
9	Ujeinstalues	2	2	2
10	Operator në GIS	1	1	
11	Gjeodet	1	1	1
12	Operator MMS/MMA	1		
13	Inspektor regional	2	1	
14	Lexues	2	2	2
15	Operator ne qendren e thirrjes	1		
16	Sigurim-Roje	1	1	
17	Shef i sektionit ne Operim dhe Mirembajtje ne Sis. Kanalizimit			1
18	Operator ne CCTV		1	1
19	Ndihmes operator ne CCTV			1
20	Teknik Mekanik	1		
21	Punetor ne kanalizim		1	
22	Shef i sektionit te elektroteknikes ITUN			1
23	Zyrtar/e per personel dhe administratë			1
24	Sigurim-Roje	1	1	1
25	Mirembajtes/e ne higjene	1		
26	Arkivist/e	1	1	
27	Zyrtar/e ligjore			1
28	Zyrtar për raportim, Plan Biznes dhe Tarifa	1		
29	Menaxher i Divisionit Financiar dhe Kontabilitet	1		
30	Shef i divisionit për UPF	1		
31	Shef i sektorit pë inkasim	1		

32	Kontist për banka/llogaritari pagave	1	1	
33	Kontist/ndihmes i zyrtarit kryesor per pasuri (Asete)		1	
34	Punetor ne depon kryesore	1	1	
35	Zyrtare Ligjore	1		
	<b>TOTAL</b>	<b>30</b>	<b>30</b>	<b>16</b>

### *Punëtorët që do të penzionohen*

Tabela:15

Nr	Përshkrimi i vendeve të punë	Nr. i punëtorëve që do të penzionohen		
		2025	2026	2027
1	Zyrtar për pranimin e ankesave/kërkesave	1		
2	Teknik laborant i kimisë	1		
3	Rojtar- kujdestar	1	4	6
4	Shef i sektorit teknik- ujësjellës	1		
5	Arkëtar/e	1	2	1
6	Lexues		4	
7	Punëtor fizik			1
8	Punëtor i përpunimit të ujit		1	
9	Inspektor/kontrollor		1	
10	Punëtor në shërbimin e kontrollësë/inspektoriatit		1	
11	Inxhinier			1
12	Menaxher i divizionit për prodhim dhe furnizim me ujë			1
13	Përgjegjës për karburante dhe vozitës i K.E			1
14	Murator			1
15	Kryepunëtor-Teknik i elektros			1
16	Kryepunëtor i rrjetit zonal dhe ngasës i makinave të rënda			1
17	Punëtor i përpunimit të ujit			1
18	Punëtor i përpunimit të ujit			1
19	Bashkëpunëtor për elektroteknik			1
20	Zyrtar kryesor për pasuri			1
	<b>TOTAL</b>	<b>5</b>	<b>13</b>	<b>18</b>

## **8. INVESTIMET – 2025 – 2027**

Kompania konform detyrimeve ligjore ka përgatitur listën e projekteve të investimeve kapitale me mjete vetanake dhe me mjete nga komunat, qeveria dhe donatorët potencial si aneks të veçantë të këtij PB, për periudhën 2025-2027.

Për zgjedhja e projekteve investive për periudhën trevjeçare në harmoni të plotë me sugjerimet dhe rekomandimet e ARRU-së është mbështetur kryesisht në:

1. PMA – Plani i menaxhimit të aseteve, statusi i prioriteteve dhe rangimi sipas kritikalitetit
2. Strategjia zhvillimore e Kompanisë - "Plani i Investimeve Afatgjate 2018-2028" .
3. Strategjia dhe Plani i veprimit 2023-2025 për zvogëlimin e humbjeve të ujit
4. Gjendja dhe funksionaliteti i gjithëmbarshëm i infrastrukturës ekzistuese të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit brenda zonës së mbulueshmërisë.
5. Harmonizimi i projekteve investive me projektet kapitale sipas linjave buxhetore komunale, qeveritare, donatore dhe shenimeve e të dhënave të pranuara apo parashikimeve të besueshme të tyre për investimet në perspektivë.
6. Kërkesave dhe ankesave përgjatë kohës nga konsumatorët, zonave, lokaliteteve e më gjerë për zgjidhje të qëndrueshme të problemeve të shfaqura në furnizim dhe distribuim.
7. Shyrtimeve, matjeve, studimeve, analizave dhe zgjidhjeve profesionale të vazhdueshme konform dokumentacioneve e të dhënave dixhitale e fizike në dispozicion.

Vështirësitetë në përbushjen e objektivave;

- Rrjeti i ujësjellësit dhe infrastruktura e gjithëmbarshme e sistemit të ujësjellësit me përqindje të lartë e amortizuar dhe në gjendje të pavolitshme teknike e kondicionale
- Mosrealizimi i projekteve të parapara nga linjat buxhetore komunale, qeveritare apo donatorëve tjera.
- Kosto shume e larte financiare për investime kapitale si rezultat i ndryshimeve të mëdha të rrjedhave globale në të gjitha dimensionet përfshi çmimet e tregut, prodhimin, furnizimin, fuqinë punëtore, etj.

- Mundësitë e limituara buxhetore të kompanisë.
- Dështimi i proceseve të prokurimit në mungesë të ofertuesve apo nga pasuria e ofertuesve për shkak të migrimit përkatësisht largimit të fuqisë punëtore dhe sigurisë së tyre financia

## 8.1 INVESTIMET-NGA KRU- 2025 – 2027

Tabela:16

KRU		VITET				TOTAL
Nr.	Investimet & mirëmbajtja kapitale	Prioritetizimi	2025	2026	2027	2025-2027
1	Reabilitimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për përmirësimin e furnizimit dhe zvogëlimin e humbjeve në zonën e shërbimit të KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A (Prizren, Suharekë, Malishevë, Dragash)	1	€ 250,325.00	€ 300,000.00	€ 320,000.00	€ 870,325.00
2	Përgatitja e ToR dhe instalimi e funksionalizimi i sistemit parcial të kontrollit - SCADA, duke përfshire instalimin e ujematësve të prodhimit, krijimin e DMA-ve në njësítë distributive të ujit të pijes në gjithë zonën e shërbimit.	2	€ 40,000.00	€ 80,000.00	€ 90,000.00	€ 210,000.00
3	Furnizimi me elektropompa dhe paisje komanduese, komunikuese e tjera përiplëndritje dhe optimizim të eficiencës elektroenergetike sipas prioriteteve dhe zgjidhjeve investuese të KRU "HRJ" Sh.A.	3	€ 15,000.00	€ 20,000.00	€ 25,000.00	€ 60,000.00
4	Identifikimi dhe përcaktimi i zonave mbrojtëse ujore	5	€ 10,000.00	€ 15,000.00	€ 15,000.00	€ 40,000.00
5	Reabilitimi dhe ndërtimi i objekteve hidroteknike dhe punuese në gjithë zonën e shërbimit të KRU HRJ.	1	€ 50,000.00	€ 55,000.00	€ 60,000.00	€ 165,000.00

6	Realizimi i aktiviteteteve në kuadër të "Strategjisë së Zvogëlimit të Humbjeve të Ujit 2023-2025" në gjithë zonën e shërbimit të KRU HRJ.	1	€ 32,500.00	€ 35,000.00	€ 40,000.00	€ 107,500.00
7	Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në kuadër të mbulueshmërisë brenda zonës së shërbimit .	3	€ 180,000.00	€ 180,000.00	€ 180,000.00	€ 540,000.00
8	Zgjerimi i kapaciteteve prodhuese të ujit- hapja e puseve nëntokësore në zonën e shërbimit të KRU HRJ.	4	€ 15,000.00	€ 20,000.00	€ 25,000.00	€ 60,000.00
9	Zevëndësimi i valvula mekanike me ato elektronike të cilat manipulohen nga distanca si dhe vendosja e manometrave për matjen e presionit në sistemin e rrjetit të ujësjellësit në KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A	5	€ 32,500.00	€ 35,000.00	€ 40,000.00	€ 107,500.00
10	Furnizimi me mjete të transportit, makineri dhe mekanizëm për mirëmbajtjen dhe operimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit (kamionetë, eskavator, vetura, etj.).	4	€ 40,000.00	€ 75,000.00	€ 80,000.00	€ 195,000.00
11	Furnizim me pajisje të IT-së për operim dhe avansim të shërbimeve punuese në gjithë zonën e shërbimit (PC, laptop, kamera, printerë, servera, etj.).	3	€ 15,000.00	€ 20,000.00	€ 20,000.00	€ 55,000.00
12	Implementimi, avansimi dhe mirëmbajtja e liçensave të programeve softverike për shëbimet operuese dhe punuese të KRU HRJ .	1	€ 30,000.00	€ 35,000.00	€ 36,000.00	€ 101,000.00
13	Furnizimi me pajisje dhe vegla të punës për shërbimet e operimit dhe mirëmbajtjes në gjithë zonën e shërbimit të KRU HRJ.	4	€ 18,000.00	€ 20,000.00	€ 20,000.00	€ 58,000.00

14	Reabilitimi, ndërtimi dhe zgjerimi i sistemit të kanalizimit në kuadër të mbulueshmërisë brenda zonës së shërbimit.	3	€ 122,516.00	€ 130,000.00	€ 140,000.00	€ 392,516.00
15	Furnizimi me pajisje të ndryshme për operim dhe mirëmbajtje të ITUN-së.	5	€ 65,000.00	€ 65,000.00	€ 65,000.00	€ 195,000.00
16	Furnizimi me autocisternë thithëse-shtytëse të kanalizimit për nevojat e Operimit dhe Mirëmbajtjes në rrjetin e kanalizimit	2	€ 115,000.00	€ -	€ -	€ 115,000.00
17	Identifikimi dhe digjitalizimi i sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit në gjithë zonën e shërbimit të KRU HRJ (angazhimi i stafit, pajisjeve përcjellëse dhe infrastrukturës)	2	€ 30,000.00	€ 35,000.00	€ 37,000.00	€ 102,000.00
18	Avansimi dhe trajnimi i stafit të KRU HRJ-së	5	€ 5,000.00	€ 15,000.00	€ 15,000.00	€ 35,000.00
19	Hartimi i projektdokumentacioneve investive, hulumtuese e studimore.	4	€ 17,000.00	€ 20,000.00	€ 20,000.00	€ 57,000.00
20	Bashkëfinancimi për projekte të ndryshme për sisteme të ujësjellësit dhe kanalizimit me: komunat, qeverinë, komunitetin dhe donatorët në zgjerimin, rehabilitimin, hulumtimin, shtimin e kapaciteteve të ujit, zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe nevojave tjera sipas kërkësave të subjekteve të lartshënuara.	1	€ 80,000.00	€ 100,000.00	€ 100,000.00	€ 280,000.00
<i>Sqarim:</i>						
Rangimi prej 1-5 është bërë mbi bazën e rëndësisë së investimit			€ 1,162,841.00	€ 1,255,000.00	€ 1,328,000.00	€ 3,745,841.00

## 8.2 INVESTIMET –NGA KOMUNAT- 2025 – 2027

Tabela:17

KOMUNAT		VITET			TOTAL	
Nr.	Investimet kapitale	Komuna	2025	2026	2027	2025-2027
1	Rehabilitimi i rrjetit te ujesjellesit ne rrugen: "Vëllezërit Dehiri" - Prizren	Komuna e Prizrenit	€ 55,000.00	€ -	€ -	€ 55,000.00
2	Rehabilitimi i rrjetit te ujesjellesit ne rrugen: "Halim Spahiu" dhe vendosja e ujemateseve jashte prones private - Prizren	Komuna e Prizrenit	€ 60,000.00	€ -	€ -	€ 60,000.00
3	Rehabilitimi i rrjetit te ujesjellesit ne Rr." Jusuf Gërvalla" - Prizren	Komuna e Prizrenit	€ 160,000.00	€ -	€ -	€ 160,000.00
4	Rehabilitimi i rrjetit te ujesjellesit ne rruget e qytetit te Prizrenit duke vendosur pusetat dhe ujematesat jashte prones private (rrugë dytësore në lagjen Jeta e Re) - Prizren	Komuna e Prizrenit	€ 200,000.00	€ 150,000.00	€ 80,000.00	€ 430,000.00
5	Zhjerimi i rrjetit te ujesjellesit brenda zones se sherbimit, ne lagjen Dardania (Ruga per fshatin Gërmçar) - Prizren	Komuna e Prizrenit	€ 70,000.00	€ -	€ -	€ 70,000.00
6	Rehabilitimi i rrjetit te ujesjellesit ne rruget: "Xhavit Bajraktari, Negjat Matranci, Saraj dhe rrugeve dytësore" - Prizren	Komuna e Prizrenit	€ 180,000.00	€ -	€ -	€ 180,000.00
7	Rehabilitimi, ndërtimi i gypsjellësit kryesorë Ø350mm nga AC në PE dhe zgjërimi i zonës së shërbimit në rrugët "Tirana, Turgur Ozal, Besim Shala dhe ish zona Industriale" - Prizren	Komuna e Prizrenit	€ 200,000.00	€ 300,000.00	€ 300,000.00	€ 800,000.00

8	Reabilitimi i rrjetit te ujesjellesit nga rezervuari i Tususit (dalja nga Rez.) dhe ne rruget: "Ismet Jashari, Sheh Emini dhe Sylejman Vokshi" - Prizren	Komuna e Prizrenit	€ 200,000.00	€ 100,000.00	€ 100,000.00	€ 400,000.00
9	Reabilitimi I rrjetit te ujesjellesit ne lagjen "Te Kullat"	Komuna e Prizrenit	€ 250,000.00	€ -	€ -	€ 250,000.00
10	Reabilitimi I rrjetit te ujesjellesit Ø200/16bar ne lagjen "Kurilla"	Komuna e Prizrenit	€ -	€ 400,000.00	€ -	€ 400,000.00
11	Reabilitimi I rrjetit te ujesjellesit Ø250/10bar ne lagjen "Kurilla"	Komuna e Prizrenit	€ 300,000.00	€ -	€ -	€ 300,000.00
12	Reabilitimi dhe zonimi i rrjetit në lagjen "Kurilla" Prizren	Komuna e Prizrenit	€ 200,000.00	€ -	€ -	€ 200,000.00
13	Reabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja e ujëmatësve jashtë pronës private në fshatin Lutogllavë - Prizren	Komuna e Prizrenit	€ 320,000.00	€ -	€ -	€ 320,000.00
14	Shtimi i kapacitetit te ujit të pijës në Komunen e Prizrenit - monitorimi dhe matjet e prurjeve të ujit ë pijes nga burimet Vërmica, Poslišti dhe Nasheci.	Komuna e Prizrenit	€ 200,000.00	€ 1,500,000.00	€ 2,000,000.00	€ 3,700,000.00
15	Reabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në fshtatin Bllacë Faza III-të para futjes nën menagjimin e Kompanisë	Komuna e Suharekës	€ 250,000.00	€ -	€ -	€ 250,000.00
16	Zgjerimi i zones se sherbimit, rehabilitimi i drenazhes dhe kaptazhes në burimin e ujit si dhe realizimi i kyçeve shtepiake ne fshatin Maqiteve - Suharekë	Komuna e Suharekës	€ 50,000.00	€ -	€ -	€ 50,000.00

17	Reabilitimi I rrjetit të ujësjellësit dhe zgjërimi i zonës së shërbimit në rrugët "Kenan Halimi, Hajdin Berisha, Xhavit Syla 1, Nëna Tereza dhe Lagja e Urbanizuar" - Suharekë	Komuna e Suharekës	€ 150,000.00	€ 200,000.00	€ 200,000.00	€ 550,000.00
18	Reabilitimi i gypit të ujësjellësit PE fi 110mm Rr."Imer Krasniqi" Malishevë L=1,500.0m	Komuna e Malishevës	€ 150,000.00	€ -	€ -	€ 150,000.00
19	Reabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja ujmëmatësve jashtë pronës private në fshatrat: Temeqinë dhe Janqishtë	Komuna e Malishevës	€ 150,000.00	€ 50,000.00	€ -	€ 200,000.00
20	Reabilitimi dhe ndërtimi I rrjetit të ujësjellësit në Rr. Hamdi Berisha, L=1600m' si dhe vendosja e ujmëmatësve jashtë pronës private	Komuna e Malishevës	€ 294,500.00	€ -	€ -	€ 294,500.00
21	Ndërtimi I objektit administrativ dhe operativ për njësinë punuese Dragash	Komuna e Dragashit	€ 181,000.00	€ -	€ -	€ 181,000.00
	TOTAL		€ 3,620,500.00	€ 2,700,000.00	€ 2,680,000.00	€ 9,000,500.00

### 8.3 INVESTIMET –NGA QEVERIA DHE DONACION- 2025 – 2027

Tabela:18

QEVERIA-DONACION		VITET				TOTAL
Nr.	Investimet	Komuna	2025	2026	2027	2025-2027
1	Instalimi i Sistemit Solar Fotovoltaik për 4 komuna (Prizren, Suharekë, Malishevë dhe Dragash) në kuadër të stabilimenteve elektrike - stacione të	Prizren Malishevë Suharekë Dragash	€ 1,800,000.00	€ 1,850,000.00	€ 1,850,000.00	€ 5,500,000.00

	pompave.					
2	Furnizimi dhe instalimi i ujëmatësve të mençur (smart watermeter) për zonën e shërbimit.	Prizren Malishevë Suharekë Dragash	€ 500,000.00	€ 600,000.00	€ 600,000.00	€ 1,700,000.00
3	Instalimi i Sistemit të Kontrollit SCADA në nivel regional dhe instalimi i ujëmatësave të prodhimit në nivel regional	Prizren Malishevë Suharekë Dragash	€ 900,000.00	€ 1,500,000.00	€ 300,000.00	€ 2,700,000.00
4	Ndërtimi i objektit të administratës qëndrore të KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A	Prizren	€ 650,000.00	€ -	€ -	€ 650,000.00
5	Rehabilitimi i rrjetit te ujesjellesit PEHD (Ø160, Ø110, Ø90, Ø63)mm dhe vendosja e ujëmatësve jashtë pronës private, në rrugën "Xhemë Gostivari" - Prizren (354-Kons dhe 1,440.0m')	Prizren	€ 250,000.00	€ -	€ -	€ 250,000.00
6	Ndërrimi i komplet rrjetit të ujësjellësit nga materiali ACC në PE për qytetin e Prizrenit , Rikonstrukcion i rrjetit shpërndarës përfshirë edhe monitorimin frekuent të variablate	Prizren	€ 500,000.00	€ 1,250,000.00	€ 2,300,000.00	€ 4,050,000.00

7	Ndërtimi i Rezervuarit, Stacionit të Pompave dhe Gypave përcjellës të Pusi i Atit në Greikoc" – Suharekë	Suharekë	€ 890,000.00	€ -	€ -	€ 890,000.00
8	Ndërtimi i Ujësjellsëve të ri, për fshatin Budakovë, Papaz, Krushicë, Buzhalë	Suharekë	€ 300,000.00	€ 300,000.00	€ 300,000.00	€ 900,000.00
9	Reabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja ujëmatësve jashtë pronës private në fshatrat: Tërpezë e ulët, Ngucat, Lladroviç, Panorc, Senik dhe Rud.	Malishevë	€ 150,000.00	€ 150,000.00	€ 150,000.00	€ 450,000.00
10	Reabilitimi dhe zevëndësimi i gypit transportues nga burimi i Banjës në qytetin e Malishevës me gjatësi L=5km.	Malishevë	€ 300,000.00	€ 400,000.00	€ 450,000.00	€ 1,150,000.00
11	Studimi i fizibilitetit përfurnizim me ujë të pijes në komunën e Malishvës	Malishevë	€ 70,000.00	€ -	€ -	€ 70,000.00
12	Ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit nga materiali ACC në PE për komunën e Dragashit, rikonstrukcioni dhe zonimi i rrjetit shpërndarës.	Dragash	€ 150,000.00	€ 150,000.00	€ 150,000.00	€ 450,000.00
<b>TOTALI:</b>			<b>€ 6,460,000.00</b>	<b>€ 6,200,000.00</b>	<b>€ 6,100,000.00</b>	<b>€ 18,760,000.00</b>

## Organogrami – KRU „Hidroregjioni Jugor” Sh.A

